



STUDIMET PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

TEZA:

**“ROLI I DREJTORIT NË ZBATIMIN E METODAVE BASHKËKOHORE
NË MËSIMDHËNIE, NË SHKOLLAT FILLORE NË TETOVË”**

Kandidat:

Ulifet Plava Saiti 106859

Mentor:

Prof. dr. Arafat Shabani

Tetovë, Prill, 2019

STRUKTURIMI I PUNIMIT

Abstrakti

Përmbajtja

(Pjesa I)

Kreu I

Hyrje.....	10
1.1. Arsimi dhe menaxhimi	12
1.2 Kuptimi mbi arsimin	12
1.3.Trekëndëshi (nxënësi, familja dhe shkolla).....	14
1.3.1.Nxënësi	14
1.3.2.Shkolla.....	14
1.3.3.Familja.....	16
1.4.Kuptimi mbi menaxhimin.....	17
1.4.1.Menaxhimi.....	17
1.4.2.Procesi i menaxhimit	18
1.4.3.Konceptet e menaxhimit	20
1.5.1.Qyteti i Tetovës edukimi dhe arsimi	21
1.5.2.Problemet në shkollat fillore në Tetovë	21
1.6.Drejtori dhe puna e tij në shkollë	22
1.6.1 Shkolla fillore “Naim Frashëri”-Tetovë.....	22
1.6.2 Shkolla fillore “Liria”-Tetovë	22

Kreu II

2.1. Metodatat bashkëkohore në mësimdhënie.....	23
2.2.Cila është mësimdhënia e mirë.....	23
2.3.Mësimdhënia bashkëkohore.....	24
2.3.1.Çka kuptojmë me termin “mësimdhënia bashkëkohore”	24
2.3.2.Si bëhet mësimdhënia bashkëkohore	25
2.3.3.Parimet e mësimdhënies bashkëkohore	26
2.3.4.Roli i nxënësit në mësimdhënien bashkëkohore.....	26
2.4.Kuptimi mbi metodatat	27
2.5.Llojet e metodave	28
2.5.1.Klasifikimi i metodave mësimore	28
2.5.2.Metoda e demonstrimit dhe ilustrimit në mësim	30
2.5.3.Metodat laboratorike-eksperimentale dhe e punimeve praktike	30
2.6.Mësimdhënia dhe llojet e saj	31
2.7.Roli dhe rruga evolutive e metodave mësimore.....	33
2.8.Korelacioni ndërmjet metodave mësimore	34
2.9.Të mësuarit me kuptim	35
2.10.Të mësuarit gjatë gjithë jetës në një shoqëri të dijes	37

(Pjesa e II)

Kreu III

3.1. Qëllimi i hulumtimit	38
3.2.Pyetjet kërkimore të hulumtimit	40
3.3.Hipoteza	41
3.3.1 Hipoteza gjenerale	41
3.3.2.Hipoteza e veçantë	41
3.4.Metodat e hulumtimit.....	42

Kreu IV

4.1.Analiza e të dhënave	43
4.2.Shkolla Fillore “Naim Frashëri”	43
4.3.Shkolla Fillore “Liria”	44
4.4.Statistikat e anketës me arsimtarët.....	46
4.5.Statistikat e anketës me nxënësit	52
4.6.Statistikat e anketës me prindërit	57
4.7.Intervista me drejtorin Xhelal Alili	61
4.8.Rezultatet nga sh.f.”Naim Frashëri”	65
4.9.Rezultatet nga shkolla fillore “Liria”	65
4.11.Rezultatet e anketës tek pyetsori për nxënësit	71
4.12.Intervista me drejtoreshën Shpresa Iseini”	79

4.13.Rekomandime për arsimtarët.....	85
4.15.Rekomandime për drejtorët e shkollave	87
4.11.Konkluzioni.....	89

Kreu V

• Përkufizimet dhe rekomandimet	93
• Referencat	94
• Shtojca	95

FALENDERIME

Pa dyshim, falënderimi absolut i takon vetëm Zotit të Madhërishëm.

Mirënjohje dhe falënderim special shkon për mentorin tim, Prof. Arafat Shabani, i cili ka qenë i gatshëm për bashkëpunime jo vetëm gjatë punimit të tezes se masterit, por gjatë gjithë kohës së studimeve.

Falënderoj edhe anëtarët e komisionit, Prof. Dr. Hasan Jashari dhe Prof. Dr. Hamit Xhaferi. Po ashtu, falënderoj të gjithë profesorët të cilet dhanë mundin e tyre gjatë ligjeratave, në veçanti Prof. Dr. Rashit Emini i cili ka kontribuar mjaft në këtë punim.

Dua t'i falënderoj gjithë ata që kanë kontribuar në këtë hulumtim, duke filluar nga drejtori i shkollës 'Naim Frashëri' Zt. Xhelal Alili, drejtoresha e shkollës fillore "Liria" znj. Shpresa Iseini, të cilët pa asnjë hezitim pranuan që të diskutonim për shkollën dhe menaxhimin e tyre. Gjithashtu falënderoj arsimtaren e gjuhës shqipe në shkollën fillore "Istikball" znj. Nurxhan Osmani e cila ka qenë e përkushtuar në lektorimin e punimit tim.

Nje falenderim tjeter shkon per arsimtarët te cilet me kushtuan kohe nga koha e tyre dhe ndihmuan me pergjigjet e tyre ne plotesimin e ketij pyetesori. Gjithashtu nje falenderim tjeter u shkon nxeneseve te vegjel te po ketyre shkollave per pergjigjet e tyre te sinqerta. Falenderoj gjithë stafin pedagogjik të këtyre shkollave fillore.

Falenderoj prindërit e mi të cilët më rritën në një ambient ku studimi dhe leximi ishin një element shumë i rëndësishëm në jetë. Më krijuan besimin në vete se çfarëdo synimi që njeriu ka sado i vështirë të jetë, me punë dhe vendosmëri arrihet.

Nuk mund të mos përmend këtu ndihmën e pakursyer të prindërve të dytë (vjeherit) që janë gjendur gjithmonë pranë meje në mënyra të ndryshme duke më dhënë mbështetje dhe inkurajim të vazhdueshëm për të ecur përpara. Ata kanë qenë një mënyrë për të na dhënë qetësinë e nevojshme mua dhe fëmijëve të mi, sa herë që unë nuk u jam gjendur dot pranë atyre. Më mbështetën dhe inkurajuan vazhdimisht që studimet e mia të vazhdonin më tej duke më krijuar të gjitha kushtet e nevojshme dhe duke më ofruar ndihmën e tyre morale dhe material.

Falenderoj gjithashtu bashkëshortin tim që më ka ndenjur pranë dhe më ka mirëkuptuar në çdo hap të këtij studimi dhe iu ka dhënë fëmijëve ngrohtësinë e duhur që të mos e ndienin mungesën time.

DEKLARATË MBI ORIGINALITETIN E PUNIMIT

Me anë të kësaj deklarate, unë Ulifet Plava Saiti, deklaroj se punimi i kësaj teze është rezultat i punës sime origjinale dhe është bërë personalisht nga vetë unë.

Asnjë pjesë e këtij punimi nuk është marrë nga askush pa qenë e cituar sipas standardeve të pranuara. Po ashtu, vërtetoj se ky punim apo pjesë të tij nuk janë botuar apo publikuar më parë në ndonjë aktivitet kursi, qoftë nga unë apo dikush tjetër.

Ky material është ideuar dhe dizajnuar duke u bazuar nga burimet e cituara duke i shfrytëzuar dhe duke u bazuar në burimet e cekura në referenca dhe në literaturën e shënuar.

Gjithashtu e bëj të qartë se, në bazë të njohurive të mia, punimi im nuk cenon të drejtat e asnjë autorit, në asnjë rast.

ABSTRAKT (Përmbledhje)

Ky punim i magjistraturës do të sqarojë se si Drejtorët e shkollave janë përgjegjës për të planifikuar, administruar, organizuar dhe menaxhuar shkollën, duke i shfrytëzuar me efikasitet dhe efektivitet mjetet në dispozicion. Duke punuar me secilin, drejtori i e shkollës mundëson bashkëpunimin me bashkësinë dhe pjesëmarrjen në rritjen e cilësisë së të nxënësve dhe të suksesit të nxënësve.

Ata i hartojnë dhe i zbatojnë politikat në nivel shkolle dhe ato në nivel kombëtar për të siguruar zbatim të suksesshëm të kurrikulumit kombëtar. Në fund, ata veprojnë me integritet, paanshmëri dhe etikë të lartë profesionale dhe të punës. Ata udhëheqin dhe mësojnë duke vepruar.

Nxitja dhe motivimi i drejtorëve të shkollave në përvetësimin dhe praktikimin në mënyrë të vazhdueshme të standardeve të praktikës profesionale gjatë planifikimit, udhëheqjes, administrimit, organizimit dhe menaxhimit të punës së shkollës, me qëllim të arritjes së vlerave të edukimit cilësor, është objektivi kryesor i këtij shkrimi.

Drejtori i shkollës nuk mund të arrijë asgjë nëse nuk bashkëpunon me të tjerët; kjo është puna e menaxhimit dhe udhëheqjes.

Drejtori i shkollës udhëheqë shkollën për të arritur më të mirën përmes:

- Përdorimit të shkathtësive personale të komunikimit efektiv;
- Krijimit të një sistemi formal të komunikimit (apo strukturës së komunikimit) që i mban të informuar prindërit, komunitetin dhe të tjerët për zhvillimet e rëndësishme të shkollës;
- Sigurimit se shkolla është mikpritëse dhe miqësore dhe din si të dëgjojë nevojat, shqetësimet dhe dëshirat e aktorëve të saj;
- Ndërtimit të marrëdhënieve personale dhe institucionale brenda shkollës dhe mes shkollës, komunitetit dhe aktorëve tjerë që forcojnë bashkëpunimin që përkrah gjenerimin e suksesit të shkollës. Komunikimi efektiv ndërton marrëdhënie dhe marrëdhëniet shpijnë në pjesëmarrje dhe bashkëpunim.

Fjalët kyçe: Tetova,, arsimi, shkolla fillore, bashkëpunimi i trekëndëshit,, menaxhimi, roli i drejtorit, metodat bashkohore në arsim.

Me anë te metodave dhe teknikave të ndryshme do te grumbullohen materiale faktografike dhe i njehti do të seleksionohet, analizohet dhe do te interpretohet me një qasje kreative dhe kritike.

KREU I.

HYRJA

Shqetësimi i parë i një drejtori të shkollës është cilësia e stafit mësimdhënës. Pa mësues të mirë është e pamundur të kemi shkollë të mirë. Drejtori duhet të udhëheqë dhe përkrahë stafin mësimdhënës përmes procesit të të mësuarit, të kuptuarit dhe implementimit të kurrikulës së re.

Kjo do të thotë të mësojë si të udhëhiqen ndryshimet, si të mbikëqyren dhe të mentorohen mësimdhënësit dhe të jetë në gjendje që së bashku me mësimdhënësit të zhvillojë një planprogram për zhvillim profesional me bazë në shkollë.

Për më tepër, e gjitha kjo lidhet me implementimin e sistemit të ri për licencim të mësimdhënësve. Ka shumë për t'u mësuar dhe ende më shumë për t'u bërë. Të gjitha shkollat kanë nevojë për një shef; dikë që ka autoritet dhe përgjegjësi të plotë por pak shkolla kanë nevojë për dikë që sillet si shef!

Ajo për të cilën shkollat kanë nevojë sot është një trajner; dikë që mund të udhëheqë shkollën gjatë një procesi intensiv të ndryshimeve. Kjo ju ofron mësimdhënësve mundësi për të nxënë së bashku. Pa qenë ekspert lëndorë, drejtorët e shkollave në vendet e zhvilluara kanë mësuar të mentorojnë mësimdhënësit dhe të zgjerojnë njohuritë e tyre gjatë procesit.

Arsimi është fushë më e rëndësishme e një shoqërie dhe kombi. Nëpërmjet arsimit, shoqërisë u transmetohen dije, kulturë, vlera ku përmes tyre shkon një shoqëri përpara. Arsimi jo vetëm që i prin shoqërisë, në të njëjtën kohë ndikohet edhe nga ndryshimet që ndodhin në shoqëri.

Një ndër çështjet më të rëndësishme në arsim janë edhe reformat.

Reforma në arsim do të thotë të vihet në zbatim politika e fundit, përmes saj të ndryshosh, kulturen e klasave, shkollave, univerzitetëve. Me anë të reformave, arsimi është

munduar t'ju përshtatet sa më shumë ndryshimeve sociale në rrethin po si dhe atyre globale.¹

¹. (Hasan Jashari Sociologjia e Arsimit fq.193.)

“Si është arsimi sot ashtu do të jetë kombi nesër.”

Një arsimimi i mirë na ndihmon të fitojmë njohuri dhe urtësi të cilët do të na aftësojnë të bëjmë dallimin e vërtetës nga e gabuara dhe të bëjmë zgjedhjen e saktë dhe të duhur për veten dhe shoqërinë. Arsimimi dhe dituria janë gjithashtu elementet kryesore për zhvillimin e personalitetit tonë, për ndërtimin e një familjeje të fortë për shërbime sociale relogjioze, dhe për të dhënë një kontribut d.m.th për shoqërinë ku jetojmë.

Arsimi është dhe do të jetë një nga fushat më të rëndësishme të cdo shoqërie dhe sistemi. Përmes arsimit shoqëritë dhe kombet u transmetojnë pjestarëve të tyre dijen, kulturën, trashigimin kulturor, vlerat, përmes së cilëve shkon përpara një shoqëri.

Në ditët e sotme në vendin tonë procesi i arsimit dhe i edukimit po reflekton një

DIS-BALANCë nga procesi i zhvillimeve shoqërore-ekonomike brenda dhe jashtë vendit.

Pjesmarësit kryesor të edukimit janë nxënësit të cilët përmes shkollimit (edukimit) arrijnë të përveçtojnë njohuri dhe vlera që na përcjellin neve gjatë tërë jetës.

Udhëheqësit efektivë të arsimit e mbështesin shkollën e tyre që ta zhvillojë një vizion që bazohet në një përkushtim të nivelit të lartë të mësimdhënies dhe mësimnxënies, që është një parakusht për arsim cilësor në shkollën e tyre.

Suksesi i udhëheqësve arsimorë në nivel shkolle varet prej strukturës së motivimit, duke përfshirë baraspeshën, angazhimin, mirëqenien, qëndrueshmërinë; prej përqendrimit në aktivitete, dëshirës dhe kënaqësisë ndaj punës dhe të arriturave.

Arritja e këtij standardi nuk bazohet vetëm në njohuri, por edhe në besim, komunikim, bashkëpunim, përkushtim dhe fuqizim të vlerave.

1.1 ARSIMI DHE MENAXHIMI SI PROCES, DREJTORI DHE METODAT

1.2. KUPTIMI MBI ARSIMIN, ROLIN E DREJTORIT DHE METODAVE

Arsimi është proces i përvetësimit të një sistemi të caktuar të diturive shkencore, përvetësimin e një sasive të caktuar njohurish dhe shprehish, të cilat janë pjesë përbërëse e praktikës arsimore dhe edukative ²

Në *Fjalorin e pedagogjisë "arsimi"* përkufizohet si "sistem i caktuar njohurish dhe shprehish të përgjithësuara në shkencat mbi natyrën, shoqërinë dhe mendimin njerëzor, që jepen në mënyrë të planifikuar dhe të programuar në institucionet arsimore (shkolla, kurse, etj.), për të mësuar dhe edukuar brezin e ri dhe masat e gjëra punonjëse; sistem i shkallëzuar nëpërmjet të cilit jepen njohuri, shkathtësi e shprehi; rezultati i përvetësimit të sistemit të njohurive, shprehive e shkathtësive i mishëruar në praktikën ³

"Dituria është gjëja më e rëndësishme, prandaj fito dituri. Edhe sikur të humbasësh ato që ke, fito dituri" –Solomoni.

"Çdo njeri ka të drejtën e arsimimit"⁴ -thuhet në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga OKB. E drejta për t'u arsimuar dhe për të fituar dituri ka një rëndësi të madhe jo vetëm për individin që e gëzon dhe e shfrytëzon këtë të drejtë, por edhe për mbarë shoqërinë. Arsimimi ka për qëllim të zhvillojë në mënyrë të plotë personalitetin e njeriut, duke e bërë atë të vlefshëm për shoqërinë. Njerëzit që fitojnë dituri, kulturë e sjellje qytetare moderne, janë të aftë të krijojnë një shoqëri të përparuar demokratike, në të cilën toleranca, drejtësia dhe mirëkuptimi do të jenë kryefjala. Të fitosh dije, do të thotë të shkosh nga e panjohura te e njohura, nga e thjeshta te e përbëra, nga e afërta deri te subjektet më të larta.

Do të thotë t'i njohësh gjërat në brendinë e tyre, të njohësh atë që është e dobishme, dhe me dobi nuk kuptojmë një përparësi materiale, por mbi të gjitha një të mirë morale.

² <https://sq.wikipedia.org/wiki/Arsimi>

³ shoqërore (Shefik Osmani:Fjalor i pedagogjisë, "8 Nëntori", Tiranë, 1983. fq. 38 – 39)

⁴ <https://sq.wikipedia.org/>

DREJTORI

Çfarë do të thotë ‘të udhëheqësh’?

A do të thotë se mjafton të kesh një titull dhe udhëheqja do të ndodhë vet?

Udhëheqësit janë agjentë të ndryshimit. Rezultati i punës së tyre mund të shihet në përmirësimin dhe në ndryshimet pozitive që ndodhin në institucionin për të cilin ata janë përgjegjës. Shumica e udhëheqësve nuk e kanë këtë nga natyra.

Fredmund Malik², na tregon se të qenit udhëheqës është profesion si të jesh arkitekt. Kapaciteti i parë është mundësia për të punuar me njerëz për të arritur një qëllim të përbashkët.

Udhëheqja mund të mësohet – dhe për të qenë më shumë se ‘udhëheqës titullar’ ‘udhëheqësi’ duhet të mësojë se si ta bëjë mirë atë.

Udhëheqja ka nevojë për ushtrim dhe praktikë. Ajo është e bazuar në qëllim; udhëheqësit e mirë mbështesin praktikën e tyre në njohuritë dhe shkathtësitë e të drejtuarit të pjesëtarëve të komunitetit të shkollës drejt arritjes së mandatit të shkollës në një nivel të cilësisë së lartë.

Për tu bërë pilot duhet të mësosh ta drejtosh aeroplanin; udhëheqja nuk është ndryshe. Askush nuk dëshiron të fluturojë me një pilot të patrajnuar!

1.3.TREKËNDËSHI NXËNËSI, FAMILJA, SHKOLLA DHE BASHKPUNIMI I TYRE ME DREJTORIN

1.3.1 NXËNËSI;

“Nxënësi duhet tipërvetsojë vlerat dhe parimet njerëzore”

- Nga Familja
- Nga Shkolla
- Nga Shoqëria

1.3.2 SHKOLLA;

Ç’ kuptojmë me efikasitetin e shkollave ?

• Për të bërë një vlerësim real për shkollën efikase ende mungon një konsensus, megjithatë Mortimore e ka përcaktuar shkollën efektive si një shkollë në të cilën nxënësi përparon më shumë se ç’ pritet nga ai , në momentin kur ai hynë në shkollë.

Në këtë mënyrë një shkollë efektive „krijon” një ekstravlerë në arritjet e nxënësve të saj në krahasim me shkollat e tjera të ngjashme.

• Shkollë efektive mund të quhet ajo shkollë e cila krijon ekstravlerë për të gjithë nxënësit e saj. (ose e përkufizuar thjesht, e tera është më e madhe se shuma e pjesëve – sinergia)⁵

Shkollat efektive

Shkollat efektive janë vende të kërkesave të larta, ku mësimdhënësit presin dhe realizojnë norma të larta pune dhe sjelljeje; ata janë të afërt me nxënësit dhe i vlerësojnë duke bërë përpjekje që t’i përfshijnë në jetën dhe në punën e shkollës.

• Shkolla dhe mësimdhënësit mund të kenë ndikim të fuqishëm në arritjet e nxënësve në shkollë.

⁵https://sq.wikibooks.org/wiki/Shkolla_dhe_komuniteti_dy_sisteme_t%C3%AB_nd%C3%ABrvarura/6

• **Tri çështje që lidhen me udhëheqjen e suksesshme:**

1. Vendosmëria (forca) dhe konsekuenca
2. Qasje bashkëpunimi – filozofia e pjesëmarrjes
3. Udhëheqja profesionale (shkalla e parë udhëheqja profesionale)

Shkolla e efektshme ka vizion dhe qëllime të përbashkëta

“Ç’ mund të ishte më e keqe se verbëria e trashëguar? „.....” të kesh sy e të mos kesh vizion “ – - Hellen Keller

Qëllimet:⁶

Avancimi i metodologjisë së regjistrimit në shkollë
Krijimi i një mjedisi të përshtatshëm
Aftësimi i mësimdhënësve për metoda e strategji të reja
Definimi i pritshmërive të larta
Aftësimi i mësimdhënësve për vlerësim
Partneriteti shkollë – mjedis
Stimulimi
Arsimimi i fëmijëve për të Drejt e Njeriut e të Fëmijëve
Avancimi i udhëheqjes profesionale

Shkolla është institucioni kryesor që merret me përfitim të dijes. Të mësuarit është mjet për edukimin e vlerave dhe zhvillimin e mendimit kritik, logjikës morale dhe edukimin ndërkulturor. Të mësuarit duhet të përfshijë zhvillimin e ndërgjegjshëm të aftësive të nxënësve dhe formimin e vlerave personale të tyre, duke i edukuar ata me tolerancën dhe vlerat demokratike.⁷
Shkolla merr një rëndësi absolute për formimin e çdo individi në jetën e tij.

⁶ https://sq.wikibooks.org/wiki/Shkolla_dhe_komuniteti_dy_sisteme_t%C3%AB_nd%C3%ABrvarura/6

⁷ www.shkolla1.weebly.com

Gjithashtu të potencojmë se në kohën e sotme, si kurrë më parë, shkolla është bërë pjesë me rëndësi e jetës komunitare dhe është ura që lidh nxënësin me komponentët e jetës sociale, duke e përgatitur atë që të bëhet pjesë integrale.

Kështu qenia njerëzore nëpërmjet një edukimi të duhur dhe cilësor bëhet e aftë ta ndërtojë vetë të ardhmen. Kjo gjë do të ndodhë në atë moment ku forcat që vënë në lëvizje mendjen dhe fizikun e këtij individi bashkohen dhe bashkëpunojnë për të nxjerrë në shoqëri njeriun që do t'i përshtatet çdo profesioni që ai do të zgjedhë, marrëdhënieve që ai do të ndërtojë më të tjerët.

Individi nuk i nënshtrohet procesit edukativ vetëm në familje, por edhe në shkollë dhe rrethet e ndryshme shoqërore ku ai bën pjesë.

Por, duhet shtuar se disa nga këto vlera merren nga institucione si familja dhe shoqëria njerëzore i transmeton ato si parime qytetare. Sipas Comenius: “Që kur lind njeriu është i rrethuar nga bota e jashtme, të cilën ai e njeh pak e nga pak me anën e shqisave.

Kjo eksperience e parë quhet ‘schola naturalis seu physica’. E dyta është më e përparuar ‘schola meta physica’, ku mësuesit nuk janë jashtë nesh por brenda nesh ku vetëm arsyeja mund të na udhëheqë”.

1.3.3 FAMILJA;

Familja është shtylla më e rrëndësishme në Edukimin e INDIVIDIT.

Në Familjet tona sa i përket rajonit tim punohet pak me fëmijët, prandaj ato i lëmë pa identitet dhe pa vlera.

Shkaku kryesor i saj njihet (pakënaqësia e gjendjes ekonomike-sociale). Por duhet të potencojmë se nuk mund të mjaftohemi vetëm me ndihma sociale, sepse të mirat që mbron familja janë më të larta se zgjedhjet që mirëqenia ekonomike mund të jap.

Pra unë mendoj se problematika e familjes sot nuk është vetëm ajo ekonomike, por janë sidomos ato të karakterit antropologjik të lidhura me natyrën e njeriut.

Pikërisht për këtë themi se NUK mund të kemi familje të mirë pa një edukim të mirë, që të prodhojë një kulturë të rregullt familjare dhe shoqërore, dhe gjithashtu të marrë pjesë aktive në edukimin e shoqërisë.

Pra familja është një burim i pashtershëm për të gjithë. Familja, si dhe rolet e formuara brenda saj janë thelbësore për një edukim të përshtatshëm të njeriut dhe për formimin e identitetit të tij në çdo fazë të jetës.

Jean Piaget do të theksonte se "...qëllimi kryesor i arsimit është të krijojë njerëz që janë të aftë të bëjnë gjëra të reja, jo thjesht të përsërisin ato që kanë bërë brezat e tjerë."⁸

Të formojnë mendje kritike që të mund të verifikojnë dhe jo të pranojnë çdo gjë që u jepet"⁹

1.4.KUPTIMI MBI MENAXHIMIN

1.4.1.MENAXHIMI

Menaxhimi, (*ang.: management - sq.: udhëheqje, prirje, lat.: manum agere = prijë me dorë*), nënkupton planifikimin, organizimin, udhëheqjen, koordinimin dhe kontrollin një organizmi (të përbër nga një ose më shumë njerëz ose grupe) për të arritur qëllimin e caktuar.¹⁰

Mary Parker Follett, (1868–1933), e definoi menaxhimin si "arti për realizimin e veprimeve përmes njerëzve", kurse Henri Fajol¹ konsideronte se menaxhimi përbëhet prej pesë funksioneve: planifikimi, organizimi, udhëheqja, koordinimi dhe kontrolli.¹¹

Mbi menaxhimin janë dhënë lloje të ndryshme të definicioneve nga ato më të thjeshtat si "menaxhimi është ajo çka menaxherët bëjnë" gjer tek ato më të detajuarat.

Njeriu i cili kryen këtë funksion njihet si menaxher ose udhëheqës.¹²

⁸ [www.slideshare.net \(Filozofia e Edukimit\)](http://www.slideshare.net/Filozofia_e_Edukimit)

⁹ <https://po.al/vlera-e-arsimit-dhe-diturise/>

¹⁰ www.menaxherat.com

¹¹ www.wikipedia.org

¹² **Vocational Business: Training, Developing and Motivating People by Richard Barrett - Business & Economics - 2003. – Faqe-51**

1.4.2.PROCESI I MENAXHIMIT TEK UDHËHEQËSI I SHKOLLËS

Drejtorët e shkollave janë përgjegjës për të planifikuar, administruar, organizuar dhe menaxhuar shkollën, duke i shfrytëzuar me efikasitet dhe efektivitet mjetet në dispozicion. Duke punuar me secilin, drejtori i e shkollës mundëson bashkëpunimin me bashkësinë dhe pjesëmarrjen në rritjen e cilësisë së të nxënësve dhe të suksesit të nxënësve.¹³

Ata i hartojnë dhe i zbatojnë politikat në nivel shkolle dhe ato në nivel kombëtar për të siguruar zbatim të suksesshëm të kurrikulumit kombëtar. Në fund, ata veprojnë me integritet, paanshmëri dhe etikë të lartë profesionale dhe të punës. Ata udhëheqin dhe mësojnë duke vepruar.

Nxitja dhe motivimi i drejtorëve të shkollave në përvetësimin dhe praktikimin në mënyrë të vazhdueshme të standardeve të praktikës profesionale gjatë planifikimit, udhëheqjes, administrimit, organizimit dhe menaxhimit të punës së shkollës, me qëllim të arritjes së vlerave të edukimit cilësor, është objektivi kryesor i këtij shkrimi

Dokumenti Standardet e praktikës profesionale për drejtor të shkollave në Kosovë, përcakton gjashtë standarde themelore në fushën e udhëheqjes arsimore:

1. Udhëheqja dhe motivimi,
2. Mësimdhënia dhe nxënia cilësore,
3. Planifikimi dhe menaxhimi,
4. Bashkëpunimi dhe ndërveprimi,
5. Legjislacioni dhe shoqëria,
6. Etika profesionale¹⁴

¹³ http://naserkastrati.weebly.com/uploads/3/8/8/3/38831473/udhezues-per-keshillin-drejtues-te-shkolles_shq.pdf

¹⁴ http://naserkastrati.weebly.com/uploads/3/8/8/3/38831473/udhezues-per-keshillin-drejtues-te-shkolles_shq.pdf

Të gjitha standardet janë të ndërlidhura dhe plotësojnë reciprokisht njëri-tjetrin, megjithatë, standardi tre, Planifikimi dhe menaxhimi, thekson në mënyrë më specifike mundësinë e përdorimit të tij në cilësinë e instrumentit vetëvlerësues për praktikën profesionale të udhëheqësve të shkollës në fushën e planifikimit dhe menaxhimit të financave të shkollës.

Gjithashtu, ky standard mund të dhe duhet të shërbejë në të ardhmen si bazë për hartimin e programeve të trajnimit për fushën e planifikimit dhe menaxhimit të buxhetit dhe financave të shkollës.

Për secilen fazë duhet të posedohen informacione specifike. Pastaj një komunikim i gjerësishëm mes pjesëmarrësve të të gjitha fazave është i nevojshëm.

Praktikat primare të procesit të menaxhimit përbëjnë:

- Identifikimi i aktiviteteve dhe detyrave të nevojshme.
- Kontrollimi i mënyrës përkatëse të parashikuar.
- Planifikimi dhe ndërtimi i resurseve dhe infrastrukturës së nevojshme.
- Kujdesi për mbarëvajtjen e plotë të punës së nevojshme.
- Mbikqyrja e ecurisë së punës.
- Kontrollimi i produkteve të ecurisë së punës dhe vlerësimi i rezultateve
- Drejtimi i korrekturës gjatë shmangieve.
- Kontrollimi i rezultatit përfundimtar.¹⁵

¹⁵ <https://dspace.aab-edu.net>

1.4.3.KONCEPTET E MENAXHIMIT

Te gjitha konceptet dhe teknikat e menaxhimit fillojnë gjithnjë nga stili kooperativ i udhëheqjes si teknika te sipërmarrjes. Këtu udhëheqësi sipas rregullit është koordinatori dhe jep informacionet në grupin punues. Grupi merr pjesë aktive në procesin e gjetjes së vendimeve. Aktualisht janë të themeluara konceptet e mëposhtme të menaxhimit:

- Modeli 7-S (ndarja e ndërmarrjes në shtatë s-sektorë: strategy, structur, systems, skills, staff, style, shared vlues; pra strategjia, struktura, sistemi, aftësia, stafi, stili dhe vlerat e përgjithshme)
- Bussiness Process Reengineering (Njohuritë e Costumer-Ralationship-Management përpunohen mirë dhe permanent në zinxhirin e prodhimit dhe procesit të ndërmarrjes)
- Lean Management ("menaxhimi i hollë" efektiv)
- Management by delegation - përmes delegimit (Detyrat ndahet nga udhëheqësi tek punëtorët, të cilët përgjigjen plotësisht në lidhje me vendimet dhe zhvillimet, p.sh. zhvillimi i një detyre të plotë konsumatore përmes një grupi të punëtorëve)
- Management by objectives - përmes objektivave (Udhëheqësit dhe punëtorët pajtohen në cfaqe të përbashkët për bashkëpunëtorët. Punëtori paraqet vet rrugën e arritjes së cakut. Më në fund paraqitet një krahasim "do të duhej - është". Përshebull një formulim realist dhe eksakt i cakut: "rritje fitimi prej 5%")
- Management by exception - përmes përjashtimit (Punëtorët vendosin dhe veprojnë të pavarur në situatat normale dhe raste të zakonshme. Udhëheqësit ndërhyjnë vetëm në raste dhe situata të jashtzakonshme. Për shembull në rastin e mëposhtëm paraqitet një rast normal: dhënja e rabatit deri në lartësi maksimale prej 20% nga punëtorët)¹⁶

¹⁶ www.wikipedia.org

1.5.1.QYTETI I TETOVËS DHE EDUKIMI NË ARSIM

Sot Tetova posedon 7 shkolla fillore, 5 shkolla të mesme dhe 2 univerzitete.

Sipas Ministrisë së Arsimit, ndryshimet e sistemit shkollor në Maqedoni, tregojnë se arsimi është munduar të përshatet sa më tepër me ndryshimet sociale por edhe me ato globale.

A thua kështu mendojnë edhe drejtorët, arsimtarët, nxënësit dhe prindërit?

Sot një drejtues shkolle apo drejtoria e saj pothuajse nuk kanë asnjë kompetencë për sa i përket administrimit të mjediseve shkollore.

Një drejtor shkolle nuk mund të menaxhojë një hapsirë shkollore sipas interesave të shkollës sepse në radhë të parë nuk ka buxhet dhe nuk ka asnjë ligj që rregullon këtë marrëdhënie.

1.5.2 .PROBLEMET në shkollat fillore në Tetovë

- Shkollat ballafaqohen me mungesë të klasave, kabineteve, laboratorëve etj.
 - Nxënësit edhe sot e kësaj dite mësojnë nëpër bodrume ku ballafaqohen me lagështinë e madhe dhe me hapsira shumë të ngushta që janë jashtë standardeve.
 - Inventari nëpër klasa (bankat, karriket) akoma janë ata që kanë qenë para 50 viteve.
 - Nxënësit pajisen me libra në fund të vitit shkollor ose gjysma kanë e gjysma jo ose fletore të punës nuk ka mjaftueshëm.
 - Disa prej arsimtarëve mendojnë që duhet të ketë doracak shtesë për zhvillimin e procesit mësimor.
 - Përkthimet e librave janë me shumë gabime, pse mos të jenë Abetaret e njejta si në Shqipëri ose në Kosovë thonë disa nga arsimtarët.
- Ditari elektronik mendojnë që nuk është i duhur aq pasi që e kanë vendosur mësuesin në vend të administratorit, tërë ditën shkruajnë në vend që të merren me nxënësit.

1.6. DREJTORI DHE PUNA E TIJ NE SHKOLLË

Një drejtor – Drejtoresh, e mirë e bën musuesin të ndihet bashkpuntorë dhe të realizoj objektivat reale për një formim sa më cilësor të nxënësit.

Kisha rastin ta intervistoj disa drejtorë të shkollave fillore në Tetovë:

- “Naim Frashëri”, zt. Xhelal Alili si një drejtor i sukseshëm, për hulumtim në lidhje me kushtet e punës në shkolla, pabarazitë ndryshme, reformat, suksesin.
- “Liria”, znj Shpresa Iseini si një drejtoreshë, një ndër shkollat më të vjetra të qytetit, ku nxënësit e kësaj shkolle kanë qenë gjenerata që kanë pasur suksese.

K R E U II

2.1.METODAT BASHKOHORE NË MËSIMDHËNIE

Nëse në shoqërinë tonë ka profesione që janë me përgjegjësi, atëherë një prej këtyre profesioneve është ai i mësimdhënies. Mësimdhënia është një proces jo i lehtë, është veprimtari e rëndësishme shoqërore dhe me përgjegjësi. Ka mendime se mësimdhënia është art, është shkencë, apo të dyja së bashku.

”Nëse është mësimdhënia art, kërkon frymëzim, intuitë, talent e krijimtari dhe pak prej tyre mund të mësohen. Nëse është shkencë, mësimdhënia kërkon njohuri dhe shprehi që me të vërtetë mund të mësohen.”¹⁷

Ne mund të shprehim mendimin tonë se mësimdhënia e suksesshme ka këto dy anë. Prandaj edhe në tekstin e profesorit të nderuar Bardhyl Musait theksohet se: „Mësimdhënia e mirë ka brenda elemente të punës së artistit dhe të studiuesit.”¹⁸

2.2.CILA ËSHTË MËSIMDHËNIA E MIRË?

Mësimdhënia më e mirë është ajo gjatë se cilës përmbushen objektivat, aktivizohet nxënësi, nxitet ndërveprimi, përdorën pyetje të niveleve më të larta, ku nxënësi është në qendër të mësimdhënies, zhvillohen aftësitë, të menduarit kritik e krijues, bëhet reflektimi dhe nxënësi aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur.

Pra mësimdhënia është një proces i cili planifikohet, drejtohet, organizohet nga mësimdhënësi sipas stileve të të nxënësve dhe me pjesëmarrjen aktive të nxënësve, ku përvetësohen njohuri, përdoren metoda, teknika ndërvepruese, zhvillohen aftësitë, shkathtësitë, formohen shprehjet si dhe ndodhë formimi tërësor i personalitetit të nxënësve.

¹⁷ **Musai, B. (1999). Psikologji e edukimit. Tiranë:AEDP.fq.18**

¹⁸ **Musai, B. (1999). Psikologji e edukimit. Tiranë:AEDP.fq.21**

2.3.1.CKA KUPTOJMË ME TERMIN “ MËSIMDHËNIA BASHKOHORE ”

Vet emërtimi mësimdhënie bashkëkohore nënkupton një mësimdhënie ndryshe nga ajo tradicionale. Kjo nënkuptohet në shumë anë, aspekte si: në strategji, metoda, teknika, forma, ndryshimin e rolit të mësimdhënësit dhe nxënësit, mjedisin shkollor, në respektimin e të drejtave të fëmijëve, në të kuptuarit dhe të menduarit ndryshe, në përcaktimin e objektivave, në vlerësim etj.

Prandaj “Me mësimdhënie bashkëkohore duhet të kuptojmë atë lloj mësimdhënie, e cila lehtëson me forma, metoda, teknika, dhe strategji të përshtatshme në procesin e të nxënësve. ¹⁹Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton të nxënësve aktiv, të menduarit në mënyrë kritike, krijuese dhe të nxënësve me nxënësin në qendër.

Mësimdhënia bashkëkohore është gërmues i artit dhe shkencës, ku mësimdhënësi mëson vazhdimisht për vete por edhe për t’i mësuar të tjerët, nxënësit, duke u ofruar atyre njohuri sipas metodave, teknikave, teknologjisë më të re bashkëkohore. Kjo njohuri kërkon nga mësimdhënësi njohjen e stileve të të nxënësve, përcaktimin e objektivave mësimorë, përgatitjen e pyetjeve sipas niveleve të shkallshmërisë (takson.) së Blumit, përfshirjen e sa më shumë faktorëve në procesin mësimorë.

Mësimdhënia bashkëkohore i aftëson nxënësit, i nxitë ata në veprimtaritë mësimore, t’i gjejnë vet burimet e informacionit, të zhvillojnë aftësitë, shkathtësitë dhe formojnë shprehjet e tyre. Për arritjen e këtyre rezultateve duhet krijuar kushte, një mjedis të përshtatshëm mësimorë.”

Prandaj detyrë e mësuesit është të krijoj një mjedis sa më të përshtatshëm dhe mjedis të ngrohtë pune, ku secili nxënësi të ndjehet i lirshëm të shprehë mendimin e vet, të besoj në vetvete, të besojnë te mësuesi dhe shokët e tij.

¹⁹ Grup autorësh (2005). Gjokutaj Prof. Dr.M.”Mësimdhënia me në qendër nxënësin”(Pjasa e 1).Tiranë:Geer.Fq.16

Në mësimdhënien bashkëkohore planifikohen metoda, teknika, forma të përshtatshme në procesin mësimorë, ku edhe ndryshon pozita e nxënësit dhe mësimdhënësit, ku shkolla është më e hapur ndaj mjdisit shoqëror.

Prandaj për të arritur rezultate dhe suksese duhet që në planifikimin e punës mësimore të përfshihen më shumë strategji gjithpërfshirëse dhe me nxënësin në qendër, për të përmbushur një mësimdhënie dhe të nxënë cilësor.

2.3.2. SI BËHËT MËSIMDHËNIA BASHKOHORE

”Mësimdhënia është një detyrë e vështirë dhe komplekse dhe kërkon njohuri, aftësi e shprehje të shumta.” Procesi mësimorë bëhet duke u mbështetur në metodat dhe teknikat bashkëkohore, ku nxënësi mëson duke reflektuar, vlerësuar, zbuluar dhe duke zgjidhur probleme. Ajo është një proces, veprimtari që ndryshon vazhdimisht.²⁰

Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi nxitet në procesin mësimorë, veprimtari të ndryshme për përvetësimin e diturive të reja, gjithëherë duke u mbështetur në përvojën, interesin, nevojat dhe aftësitë e tyre. Prandaj edhe burimet e informacionit janë të shumta dhe të ndryshme si nga: mësimdhënësi, përvojës, teksteve, internetit dhe nga shoku-shoku përmes ndërveprimit etj.

Përmes përvojës dhe ndërtimit të saj, nxënësit i kuptojnë përmbajtjet e reja duke i zgjeruar e pasuruar ato në mënyrë kritike. Përvoja vetanake e nxënësve, interesat, nevojat dhe aftësitë janë thelbësore gjatë mësimdhënies dhe të të nxënit. Mësimdhënia bashkëkohore tejkalon të nxënit riprodhues dhe krijon kushte për të nxënit aktiv dhe zhvillimin e të menduarit. Pra kemi të bëjmë me një mësimdhënie cilësore.

²⁰ **Musai, B. (2003). Metodologjia e mësimdhënies. Tiranë :CDE ,fq. 11.**

Kjo do të thotë se nxënësi duhet të jetë në gjendje të bëjë rindërtimin e ideve, koncepteve, mendimeve përmes procesit të njohjes, veprimit dhe ndërveprimit duke përdorur të menduarit dhe funksionet e tij si: analizën, sintezën, përfundimin, gjykimin, krahasimin, vlerësimin etj.”

Mësimdhënia bashkëkohore nënkupton ndryshimin e roleve të mësuesit dhe nxënësit, me qëllimin kryesor-lehtësimi i të nxënit.”²¹

2.3.3.PARIMET E MËSIMDHËNIES BASHKOHORE

Mësimdhënia bashkëkohore mbështetet në disa parime:

- Aftëson nxënësit për të nxënit e pavarur,
- Nxitë nxënësit që të jenë nismëtar,
- Krijohet dallueshmëri në të nxënë dhe nxitet të menduarit kritik, krijues,
- Nxitë dhe krijon kushte për komunikim shumëkahor dhe të frytshëm,
- Aftëson nxënësit për vlerësim dhe vetëvlerësim.²²

2.3.4 ROLI I NXËNËSIT NË MËSIMDHËNIEN BASHKOHORE

Në procesin e mësimdhënies bashkëkohore, përveq ndryshimeve tjera ka ndryshuar edhe roli i nxënësit i cili nuk është sikurse ka qenë në mësimdhënien tradicionale në cilësinë e dëgjuesit dhe përvetësuesit pasiv të përmbajtjeve mësimore.

Tani nxënësi është në cilësinë e subjektit dhe është faktori më i rëndësishëm i cili është i pranishëm që nga planifikimi i punës mësimore, formave, metodave e teknika, objektivave e deri te përmbushja, udhëheqja dhe drejtimi i veprimtarisë mësimore.

²¹ **Rama, B. (2011). Metodatat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë.” Revista pedagogjke”.Tiranë: fq.27.**

²² **www.prezi.com**

Në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi është aktiv, ai e kupton atë që mëson, i vërteton dhe praktikon njohuritë e mësuara. Ata nxiten për të menduar në mënyrë kritike.

Gjatë veprimtarive mësimore nxënësit krijojnë, bashkëbisedojnë, diskutojnë, shqyrtojnë, zgjidhin problemet, zbulojnë (hetojnë), kritikojnë, analizojnë, gjykojnë.

Për ndryshim nga mësimdhënia tradicionale, në mësimdhënien bashkëkohore nxënësi mendon për atë që mëson, e përdorë në jetën e përditshme, ndërton përvojën dhe aftësohet për të punuar në mënyrë të pavarur.

Sot nxënësi, interesat, aftësitë, prirjet, nevojat janë pikëmbështetje e të gjitha strategjive bashkëkohore të mësimdhënies. Prandaj njohja e nxënësit përmes dosjeve, mbledhjeve të prindërve, vëzhgimit, testeve vlerësuese etj. është një çështje që duhet ta ketë parasyshë çdo mësimdhënës për ta organizuar një mësimdhënie cilësore dhe frytëdhënëse.²³

2.4.KUPTIMI MBI METODAT

Kuptimi I Fjalës Metodë

Fjala metodë rrjedh nga fjala greke methodos që do të thotë rrugë ose mënyrë

.

Metoda mësimore

Përdorimi i metodave mësimore shpie tek realizimi i qëllimeve dhe detyrave edukative dhe arsimore, përkatësisht organizimin e ecurisë didaktike të punës mësimore.

Metodat kanë rëndësi të veçantë në teorinë dhe praktikën e punës mësimore, pasi që ato përcjellin tërë ecurinë e zhvillimit të procesit mësimor.²⁴

²³ **Rama ,B. (2011). Metodat e mësimdhënies dhe ndikimi i tyre në të nxënë .”Revista pedagogjke”.Tiranë:fq.30**

²⁴ **www.wikipedia.org**

2.5.LLOJET E METODAVE

2.5.1.KLASIFIKIMI I METODAVE MËSIMORE

Gjatë zhvillimit (historik) të teorisë së didaktikës si dhe të praktikës shkollore, janë krijuar, përsosur e formuar një sërë metoda mësimore .²⁵

Janë të njohura këto metoda, respektivisht klasifikime të metodave mësimore duke u nisur prej të kaluarës e gjer më tani, si:

Sipas dr. V. POLJAK kemi këtë renditje:

- 1) metoda demonstruese,
- 2) metoda e punëve praktike,
- 3) metoda e punimeve me shkrim,
- 4) metoda e leximit si dhe puna me tekst,
- 5) metoda e të folurit dhe
- 6) metoda e shpjegimit gojorë-interpretimit me gojë

Sipas dr.T.T.PRODANOVIQ kemi këtë renditje:

1) verbale - tekstuale:

a) **verbale** - monologu i drejtëpërdrejtë,- monologu tërthorazi,- dialogu i drejtëpërdrejtë,- dialogu tërthorazi,- diskutoni i drejtëpërdrejtë,- diskutoni tërthorazi

;b) **tekstuale** - puna e drejtëpërdrejtë e arsimtarit në tekst,- puna e drejtëpërdrejtë e nxënësit në tekst,- puna similtane e arsimtarit e nxënësit në tekst,- shfrytëzimi tërthorazi i punës në tekst\

²⁵ www.prezi.com (metodat-bashkohore)

2) Metoda ilustrative - demonstruese:

a) ilustrative - ilustrimi i objekteve si dhe rezultateve të tyre,- ilustrimi i objekteve artistike,- ilustrimi i fotografive,- ilustrimi i vizatimeve,- ilustrimi i skicave,skemave,diagrameve,grafikoneve

b) demonstrimi - demonstrimi i proceseve, demonstrimi i shtatave apo momente,- demonstrimi i mardhënieve,- demonstrimi i lëvizjes,- demonstrimi i punëve operative,- demonstrimi i organizimit të punës si dhe aktiviteteve të tjera,- demonstrimi i krijimeve muzikore,- demonstrimi i emisioneve të radios,televizionit,reproduktimit të pllakave tëgramafonit ,inçizime në magnetofon,- demonstrimi i funksionit të makinave,aparateve,instrumenteve si dhe të mjeteve tëtjera teknike ndihmëse.

3) Metoda laboratorike– eksperimentale me variantet e saj

Metoda shkencore

Përdorimi i metodave shkencore shpie drejt zbulimeve dhe shpikjeve të reja.

- (Në Greqinë antike- Spartë, Athinë)
- Metoda sokratike-variant i metodave të atëherëshme-(formë dialogu)
- Komenski- përkrahës i monometodizmit

“ Bazat e nxënies së lehtë”-arrihet me një metodë të vetme, të njejtë dhe të përhershme.

- Përkrahësit e metodës universale: Loku, Rusoi, Pestaloci, etj.
- Edukimi parashkollor u frymëzua nga Frebeli dhe Montesori
- Edukimi fillor u frymëzua nga Daltoni dheVintkes

2.5.2.METODA E DEMONSTRIMIT DHE E ILUSTRIMIT NË MËSIM

Përdorimi i kësaj metode qëndron në bazën *GNOSEOLOGJIKE* të kësaj veprimtarie edukative e arsimore të organizimit të punës mësimore, prej nga zhvillohet të njohurit mendor, duke aplikuar dukuri teorike në praktikë.²⁶

Përbëhet prej dy aspekteve njohëse-mësimore që janë :

- Të vërejturit dhe përmbajtja e përvojës e shfaqur në forma të ndryshme për fenomenet e shoqërisë dhe
- dukuritë natyrore.

2.5.3.METODAT LABORATORIKO-EKSPERIMENTALE DHE E PUNIMEVE PRAKTIKE

Janë rezultat i shkallës së lartë të zhvillimit të shkencave natyrore dhe atyre teknike. Bëhet lidhja e teorisë me praktikën.

Ndikon pozitivisht në qëndrimet e nxënësve ndaj punës mësimore pasi që ata aftësohen për punë të pavarur në laboratore, duke fituar gjithnjë e më tepër inisiativë për vetëorganizim në punë.

Kësaj metode i nevojiten kushte paraprase:²⁷

Kushtet materiale-teknike

Kushtet organizative

Kushtet hapësinore

²⁶ www.wikipedia.org

²⁷ www.prezi.com

Puna laboratorike zhvillohet në disa etapa:

1. Etapa përgatitore (nga mësimdhënësi)
2. Përgatitja e nxënësve (informimi)
3. Ndarja e detyrave dhe udhëzimeve për secilin nxënës
4. Përgatitja e materialit dhe ndarja e mjeteve të punës
5. Përcaktimi i grupeve punuese laboratorike
6. Mbikqyrja e zhvillimit nga ana e mësimdhënësit
7. Konkludimi²⁸

2.6. MËSIMDHËNIA DHE LLOJET E SAJA

Në “Fjalorin e edukimit”²⁹ mësimdhënia përkufizohet si akti i të dhënit mësim në një institucion arsimor; është veprimtaria dhe drejtimi i procesit mësimor nga mësuesi. Mësimdhënia gjithnjë është një proces i qëllimshëm, ku duhet të realizohen objektivat e caktuar. Si çdo veprimtari e qëllimshme, mësimdhënia nuk ndodh rastësisht, është një proces i planifikuar, që kushtëzon realizimin e efektshëm të këtij procesi.

Mësimdhënia është:

- a)** transmetimi i njohurive nga mësuesi te nxënësi, që shoqërohet me pyetjen “Çfarë?”- çfarë do t’i mësoj atij;
- b)** organizimi dhe drejtimi i punës së nxënësit, që shoqërohet me pyetjen “Si?” dhe lehtësimi i mësimnxënies (Çfarë do të mësojë dhe si do ta mësojë nxënësi?).

²⁸ <https://prezi.com/vlgu5pë-zcpj/metoda-te-mesimdhënies/>

²⁹ Grillo, K. (2002). Fjalor edukimi (Psikologji-Sociologji-Pedagogji), Shtypur në shtypshkronjën “DITA 2000”, Tiranë, f. 182.

Sipas Banks-it mësimdhënia është një proces aktiv, në të cilin një person e ndan informacionin me të tjerët për t'i pajisur ata me njohuri, të cilat çojnë në ndryshime të sjelljes. Rather-i thekson se mësimdhënia është një proces tripolar, që përfshin mësuesin, nxënësin dhe situatën e të mësuarit dhe që çon në ndryshimin e sjelljes së nxënësit.³⁰³¹

Mësimdhënia është një proces ose një veprimtari ndërpersonale, ku mësuesi bashkëvepron me një ose me shumë nxënës dhe ndikon tek ata, por që nënkupton edhe ndikimin e nxënësve te mësuesi.³²

Në kuptimin e gjerë mësimdhënia është drejtimi nga mësuesi i situatës mësimore dhe të nxënët që përfshin:

a) Procesin paraveprues të marrjes së vendimeve për planifikimin, skicimin dhe përgatitjen e materialeve për të mësuarit dhe të nxënët, për diagnostikimin e nevojave të nxënësve, për krijimin e mjedisit mësimor, për shfrytëzimin e kohës mësimore;

b) Procesin bashkëveprues, bashkëpunimin e drejtpërdrejtë mësues – nxënës, përdorimin e metodave të mësimdhënies;

c) Fazën pasvepruese, që përmbledh: vlerësimin, vetëvlerësimin, ridrejtimin, riskicimin; caktimin e procedurave për të vlerësuar të nxënët, për të vënë nota, për të vlerësuar programin mësimor, për të vlerësuar materialet mësimore.

³⁰ 66Banks, T. (2000). Teaching learning process. Center for Aide Regulation and education. North Carolina, f. 1. 67Rather A. R. (2004). Essentials Of Instructional Technology. Publisher, Discovery Publishing House, f. 5. 68Grup autorësh. (1999). Metoda të mësimdhënies: Manual për mësuesit e rinj, AEDP, Toena, Shtypshkronja LAERT, Tiranë, f. 19

³¹ 69THE ROADMAP, Dimensions of Teaching and Learning Teaching and Learning Branch, Education

³² 68Grup autorësh. (1999). Metoda të mësimdhënies: Manual për mësuesit e rinj, AEDP, Toena, Shtypshkronja LAERT, Tiranë, f. 19

2.7.ROLI DHE RRUGA EVOLUTIVE E METODAVE MËSIMORE

Me qenë se mësimi është veprimtari shoqërore e nderlikuar dhe mjaft delikate, i cili planifikohet ose orientohet për arsimin e gjeneratave të reja, suksesi i tij varet edhe nga një komponent shumë i rëndësishëm - metoda e punës se arsimtarit në procesin mësimor – edukativ.

Për rolin e tyre ka folur pedagogu amerikan John Deëy ne librin “Demokracioni e shkolla”³⁴ thotë:

Ashtu si mjeku që duhet t’i dijë të gjitha mënyrat [metodat] në përcaktimin e diagnosës së pacientit të vet, po ashtu edhe arsimtari duhet të dijë [e zotërojë] të gjitha metodat mësimore në organizimin e mësimi.”.

Andaj, për të pasur një aktivitet solid në mësim do të thotë lipset aplikuar metodat e punës në procesin mësimor. Ky lloj, aplikimi i drejtë i tyre nga arsimtari procesi mësimor jo vetëm që nxënë

sve do t’u bëhet më i qartë, i afërt, i njohur, i lehtë, por edhe do të kuptohet e përvetsohet më mirë dhe në një shkallë më të lartë.

Kështu, roli i tyre në procesin mësimor është aq i dukshëm dhe evident sa që mund të themi se asnjë njësi mësimore që mendohet nga arsimtari për t’u zhvilluar, interpretuar, përsëritur, përforcuar, nuk mund të paramendohet pa aplikimin e metodave mësimore.

Së këndejmi, roli i metodave mësimore ka lidhshmëri të ngushtë me zbatimin e parimeve të punës mësimore permanente me nxënës konkretisht: sigurimi e harmonizimi i drejtë mes punës teorike me punën praktike, në eliminimin e mësimi dogmatik nga përmbajtja e mënyra e të mësuarit duke zhvilluar tek nxënësit mendimin kritik nga aspekti marksist – marksizmit krijues, të hapjes së perspektivës dhe

³⁴ ³⁴ www.virtualsophists.org

jokthim kah e vjetra, respektivisht në transformimin e procesit mësimor –edukativ; të nxitjes së motivacionit për mësim; të aftësisë të nxënësve dhe në punën e pavarur të tyre.

Rruga evolutive e metodave mësimore konsiston në :në njohjen e metodave mësimore, në zgjedhjen e metodave mësimore, në zbatimin e tyre në punën mësimore, në mendimin e pedagogëve – didaktikëve të dhëna për metodat mësimore, në sistemet e metodave të punës mësimore etj.

Sot çështja e krijimit dhe e shfrytëzimit të metodave e teknologjisë së re në mësim është njëra ndërkomponentët thelbore të sistemit mësimor.

2.8. KORELACIONI MES METODAVE MËSIMORE

është karakteristike në këtë drejtim puna intelektuale në fushën e didaktikës e pedagogut gjerman J.HERBART, i cili provoi e tentoi të krijojë një metodë universale, sipas së cilës do të zhvillohet përmbajtja e të gjitha lëndëve mësimore.³⁵

Andaj, "Metoda e shkallëve formale" e HERBARTIT ka

zotëruar katër variante të saja, si:

- 1)** qartësia –që nxënësi të fitojë përfytyrim pasi këto sipas tij janë themeli i jetës shoqërore
- 2)** asociacioni –që arsimtarit i krijon mundësinë për të bërë korelacionin e temave, lëmvë e lëndëve mësimore mes tyre
- 3)** sistemi- kështu, që me lëndën e re e me të vjetrën cilesohen e vërehen karakteristikat e përbashkëtatë të tyre si dhe në bazë të tyre përgjithsohen konceptet, ligjet (e reja), rregullat dhe mësimi moral,
- 4)** Gjeneralizimi –apo zbatimi i atyre gjeneralizimeve në raste të reja veç e veç. Pra, të tri variantet e para të kësaj metode HERBERTIANE paraqesin burimin induktiv, kurse varianti i fundit burimin deduktiv në procesin mësimor.

Mirëpo, sipas didaktikës bashkëkohëse nuk ka metodë universale mësimi siç kanë qenë e praktikuar në shkollë para e pas KOMENSKIT.

³⁵ [www.scribd.com.\(doc\)](http://www.scribd.com.(doc)) "Metodat e Mësimi"

Tani në shtjellimin e përpunimin e një teme mësimore lipset praktikuar një grup metoda varësisht ngaroli, karakteri, funksioni që ka për atë temë mësimore. Kështu në praktikën shkollore lipset kushtuar kujdes të duhur zgjedhjes së metodave, zbatimit të tyre dhe momenteve kur ato vijnë në shprehje në atë temë mësimore

5) Analizë mbi funksionin praktik të metodës ilustrative-demonstruese në procesin mësimor. Sikurse nxënësi që lipset të mësojë sistematikisht, po ashtu edhe arsimtari lipset sistematikisht të përsosë punën e vetë.

Kështu ai duhej t'i ketë të qarta, të afërta metodat mësimore përkatësisht sistemin e metodave mësimore konkretisht edhe metodën ilustrative-demonstruese

Kjo metodë mësimore bie në sferën e të vërejturit të gjallë.

2.9. TË MËSUARIT ME KUPTIM

Jon Deëey ishte një edukator dhe filozof përparimtar që ka shkruar rreth arsimimit amerikan në pjesën e parë të shekullit të njëzet. Një ditë, ai po vëzhgonte një leksion gjeologjie që u jepej nxënësve të klasave të mesme.

Në përfundim të leksionit, mësuesja e pyeti Deëey-n nëse dëshironte t'i bënte klasës ndonjë pyetje. Pasi e falënderoi mësuesen, Deëey, pyeti: "Çfarë do të gjenit në qoftë se do të shponi një vrimë shumë të thellë në tokë?" Pasi nuk mori përgjigje, ai e përsëriti pyetjen, por rezultati ishte i njëjtë. Më në fund, mësuesja e theu heshtjen, "Profesor Deëey," tha ajo "ju po e bëni gabim pyetjen". Duke iu kthyer klasës ajo pyeti: "Cila është gjendja e qendrës së tokës?" klasa u përgjigj me një zë, "Shkrirje vullkanike."

Kjo ndodhi, ilustron dallimin midis mbajtjes mend (ose çfarë referohet si të mësuarit rutinë) dhe të kuptuarit (ose çfarë referohet si të mësuarit të qëndrueshëm e me kuptim).

Mbajtja mend e pohimit "Gjendja e qendrës së tokës është shkrirje vullkanike" nuk është njëlloj me të kuptuarit që nëse ju shponi një vrimë në tokë eventualisht do të arrini në një shkëmb të shkrirë. Si edukatorë, ne shpesh çorientohemi nga nxënës të cilët mund të recitojnë një përsëritje të mërzitshme përkufizimesh dhe faktesh. Gabimisht besojmë se ata kuptojnë çdo gjë që po thonë. Siç e bën fare të qartë historia e Deëey-t, nuk është kështu.

Një pyetje e arsyeshme që mund të bëhet në këtë rrethanë është përse një kalim nga orientimi “e kaluar-e tashme”, tek një orientim “e tashme-e ardhme”, kërkon përqendrim tek të kuptuarit dhe jo tek mbajtja mend. Përgjigja është fare e thjeshtë. Të mësuarit rutinë lehtëson ruajtjen e të mësuarit.

Ruajtja, për nga vetë natyra e saj, sugjeron kujtesën e gjërave nga e kaluara. Nga ana tjetër, të mësuarit e qëndrueshëm e me kuptim, lehtëson transferimin e të mësuarit. Transferimi i të mësuarit mund të përkufizohet si shtrirje e asaj çfarë ka qenë mësuar në një kontekst, në kontekste të reja.³⁶

Përdorimi i frazës “kontekste të reja” sugjeron që këto “kontekste” do të hasen në të ardhmen. Atëherë, për të qenë të suksesshëm në të ardhmen, nxënësit duhet të jenë të aftë jo vetëm të mbajnë mend çfarë kanë mësuar, por ta transferojnë atë të mësuar në mjedise, situata dhe probleme të reja.

Le të jemi të qartë, mbajtja mend e ka një vend në arsimimin e fëmijëve dhe të rinjve. Por ky vend duhet të jetë mbështetës dhe jo qendror.

Nxënësit duhet të mbajnë mend emërtimet që shoqëria iu ngjit objekteve konkrete dhe ideve abstrakte. është një gjë të kuptosh domethënien e stilit impresionist të pikturës, në një mënyrë që bën të mundur për një nxënës që të përcaktojë nëse një pikturë përfaqëson apo jo këtë stil është krejt tjetër gjë të mbash mend plotësisht që impresionizmi është një stil i pikturës, i karakterizuar nga përqendrimi i përshtypjes së menjëhershme vizuale, të prodhuar nga një peizazh dhe me përdorimin e ngjyrave themelore të pa përziera dhe me goditje të vogla stimulon dritën reale të pasqyruar.

Koncepti jep të kuptuarit, emërtimi lejon komunikimin. Konceptet pa emërtime e bëjnë komunikimin të vështirë. Emërtimet pa konceptet që janë në bazë të tyre, shumë shpesh janë të pakuptimta.

³⁶ file:///C:/Users/ulipl/OneDrive/Desktop/teaching_for_learning_alb.pdf

2.10.TË MËSUARIT GJATË GJITHË JETËS NË NJË SHOQËRI TË DIJES.

Industrialisti amerikan Henry Ford dikur ka thënë: “Çdo njeri që pushon së mësuar, është plak, qoftë ai në moshën 20 apo 80 vjeç. Çdo njeri që vazhdon të mësojë mbetet i ri. Gjëja më e madhe në jetë është ta mbash mendjen tënde të re.”

Kjo dogmë është e pajtueshme me atë që mund të jetë synimi përfundimtar i shkollimit, orientuar drejt të ardhmes; domethënë t’i përgatisë nxënësit të aftë dhe të gatshëm, të mësojnë gjatë gjithë jetës. Përse është kaq i rëndësishëm i ashtuquajturi “të mësuarit gjatë gjithë jetës”? Të paktën tre përgjigje mund t’i jepen kësaj pyetje.

E para, është llogaritur që fëmijët e tanishëm të moshës shkollore dhe të rinjtë do t’i ndërrojnë vendet e punës nga pesë deri në shtatë herë gjatë jetës së tyre. Disa nga këto ndryshime do të jenë rezultat i ndryshimeve në shoqëri. Gjyshi im ishte farkëtar. Me zëvendësimin e kuajve nga automobilat si mënyrë kryesore transporti, nevoja për farkëtarë ra. Si rrjedhim, gjyshi u detyrua

Mësimdhënia e një ndryshimi: perspektiva dhe një vështrim i përgjithshëm të ndërronte profesion, duke zënë punë si shitës në një dyqan artikujsh metalikë. Ndryshime të tjera do të bëhen si rezultat i shanseve të shtuara, të ofruara nga arsimimi plotësues dhe/ose përvoja. Me arsimim plotësues, një artist mund të bëhet arkitekt. Me përvojë plotësuese, një shitës në një dyqan veshjesh mund të bëhet blerës.

E dyta, siç është aluduar për këtë në paragrafi n e mëparshëm, shoqëritë po ndryshojnë vazhdimisht. Gjatë shekullit të kaluar, shoqëritë e bazuara te bujqësia iu hapën rrugën shoqërive të industrializuara, të cilat po zëvendësohen me ato që UNESCO iu referohet si “shoqëri e dijes”³⁷

³⁷ [file:///C:/Users/ulipl/OneDrive/Desktop/teaching for learning alb.pdf](file:///C:/Users/ulipl/OneDrive/Desktop/teaching%20for%20learning%20alb.pdf)

K R E U III

3.1.QËLLIMI I HULUMTIMIT

Metodat dhe teknikat e të mësuarit kanë qenë gjithmonë pjesë kryesore e arsimit ,varësisht nga koha,rrethanat ,vendet ,NDRYSHIMI i Metodave dhe Teknikave ka arritur të sjell risit dhe ndryshimet me vete.

Hulumtimi i kësaj teme ka pasur për qëllim t'i nxjerrë në pah ROLIN E DREJTORIT NË ZBATIMIN E METODAVE BASHKËKOHORE NE MËSIMDHËNIE NËPËR SHKOLLAT FILLORE NE TETOVË, respektivisht cilësitë e drejtorit të shkollës, si parakusht për një shkollë të suksesshme. Krahas kësaj është vënë në spikamë edhe domosdoshmëria e bashkëveprimit edhe të organeve tjera drejtuese të shkollës ,me udhëheqësin, respektivisht roli përcaktues i tijt në këtë aspekt.

- Në këtë hulumtim do të punohet mbi punën e drejtorit të shkollës i cili si qëllim kryesor duhet të ketë ngritjen e suksesit të nxënësve.
 - Për ngritjen e suksesit të nxënësve do të hulumtohet puna e drejtorit se sa dhe si ai punon, çfarë bashkëpunimi ka me mësimdhënësit dhe nxënësit'
 - Analizat e mbledhura do të verifikojnë faktin se menaxhimi i shkollës dhe menaxherët (liderët) janë të suksesshëm kur në përgjithësi përparojnë kushtet e punës së shkollës, cilësia e mësimiit që zhvillohet në to, furnizimi me materiale, tekste shkollore etj.
 - Paralelisht hulumtimi do të ketë rezultatin e tij final për ta konstatuar se cilët metoda dhe teknika po perdoren gjatë mësimdhënies.
 - Punimi do të jetë I bazuar në literaturën mbi metodat dhe teknikat bashkohore që përdoren nëpër shkollat fillore,nga autor të huaj si dhe ata të vendit.

Shkolla është vendi ku procesi i të mësuarit të jep dituri,ose të paktën konsiderohet si një përvojë pozitive.Nëse të mësuarit aktiv,kritik dhe krijues bëhet i kuptueshëm dhe i rëndësishëm, atëherë nxënësit do të jenë më entuzist dhe ora e mësimit nuk do të jetë e lodhshme.

Kur vendoset se cilat metoda të përdorni në mësimdhënie,është e rëndësishme të kujtoni se metodat dhe teknikat janë vetëm hapa për të aritur një qëllim dhe jo qëllim në vetëvete.

Për të pasur suksese, gjeneratat në vijim duhet patjetër të kemi reforma në metodat dhe teknikat e mësimdhënies.Gjatë këtij procesi Mësuesi është në qendër I cili duhet të dijë t'i përdor metodat dhe teknikat e duhura në vend të duhur.

Mësuesi duhet të zgjedh metoda që do ti ndihmojnë më mirë nxënësit të kuptojë përmbajtjen ,doktrinat dhe parimet e një blloku të vecantë të shkrimit ,të leximit dhe të kuptuarit.

Në këtë punim kemi trajtuar temën:

“ROLI I DREJTORIT NË ZBATIMIN E METODAVE BASHKËOHORE NË
MËSIMDHËNIE,NEPER SHKOLLAT FILLORE NE TETOVË”

Nëpërmjet këtij hulumtimi kemi paraqitur gjendjen momentale në këtë drejtim, në shkollat fillore në Tetovë. Gjithashtu kemi hulumtuar rolin e drejtorit, rëndësinë e drejtorit në ngritjen e suksesit të nxënësve, motivimin e mësimdhënësve për punë, sa mirren në konsideratë mendimet e mësimdhënësve për metoda të reja,çfar roli luan drejtori në zbatimin e metodave të reja,çfar kushte ofron drejtori.

Duke shfrytëzuar bashkpunimin tim me drejtorët e shkollave ,me arsimtarët e shkollave ,me nxënësit e dashur të këtyre shkollave, dhe shfrytëzimin e burimeve tjera, besoj se ja kam arritur qëllimin e këtij hulumtimi.

Mendoj që materialet e mbledhura në këtë punim ishin të lidhura mirë në mes veti, duke ofruar të dhëna reale mbi gjendjen e shkollës, mbi punën e drejtorit të shkollës dhe rolin e tij në ngritjen e suksesit të nxënësve, për të pasur një arsim sa më cilësor, pasi që nuk po i kushtohet shumë rëndësi kësaj problematike dhe të nxisim drejtorët e shkollave që ti kushtojnë rëndësi më të madhe punës së tyre në suksesin e nxënësve.

- *Lëndë hulumtimi do të jetë edhe cilat janë metodat bashkohore që i përdorin mësuesit tanë në shkollat fillore në Tetovë ?*
- *Sa janë mundësit për të poseduar metoda bashkohore?*
- *Cfarë ndryshime sjellin metodat bashkohore?*
- *Cilat janë rezultatet dhe sukseset e përdorimit të metodave dhe teknikave bashkohore?*

3.2.PYETJET KËRKIMORE TË HULUMTIMIT

Realizimit të hulumtimit i paraprijnë edhe pyetjet kryesore :

- Qëllimi i këtij hulumtimi do të jetë se cfarë roli luan drejtori i shkollës në zbatimin e metodave bashkëkohore nëpër shkollat fillore
- Gjithashtu si qëllim i punimit është të hulumtojmë cilat metoda bashkëkohore janë të nevojshme për të aritur sukses dhe për ta zhvilluar arsimin në shkollat fillore në Tetovë.
- Cfarë roli luan mësuesi gjatë implementimit të metodave bashkëkohore?

3.3.HIPOTEZA

Puna dhe roli i drejtorëve të shkollave, në kushte kur një numër i madh i faktorëve të jashtëm veprojnë në shkolla është para sfidave të mëdha. Roli i tyre në ngritjen e suksesit të nxënësve dhe në zbatimin e metodave të reja bashkohore është si rrjedhim i transformimit gjithnjë e më të madh të jetës sociale e veçmas të shkollës si shtëpi e dijes.

Hipotezat kryesore te ketij punimi jane 2;

1.Hipoteza gjenerale

Roli i drejtorit në zbatimin e metodave bashkëkohore në mësimdhënie nëpër shkollat fillore në Tetovë.

2.Hipoteza e vecant

- Cfar roli luajnë metodat bashkëkohore e të mësuarit për të pasur sukses
- Reformat dhe ndryshimet ne zbatimin e tyre
- Koncepti per arsimin fillor nentevjecar,
- Sistemi Cambridge

Supozojmë se drejtorët e shkollave nuk kontribuojnë mjaftueshëm në ngritjen e suksesit të nxënësve duke mos përdorur mjete,metoda të reja bashkëkohore.. Tani dhe në të ardhmen, roli dhe puna e tyre duhet të fitojë cilësi dhe vizion të ri bashkëkohor.

Supozojmë se drejtorët e shkollave nuk kanë bashkëpunim të mjaftueshëm me mësimdhënësit, nxënësit, komunitetin etj.

3.4.METODAT E HULUMTIMIT

Për realizimin e hulumtimit *“Roli i drejtorit në zbatimin e metodave bashkohore në mësimdhënie nëpër shkollat fillore në Tetovë”*, janë përdorur këto metoda:

- **Metoda e analizës teorike**, me anë të kësaj metode kemi analizuar literaturën përkatëse që lidhet me objektin e hulumtimit dhe përgjigjet e dhëna në pyetësor, të cilat i kemi përmbledhur përmes metodës së sintezës.

- **Metoda krahasuese**

Me ndihmën e kësaj metode, kemi bërë krahasime me rezultatet e fituara në këtë hulumtim.

- **Metoda përshkruese**

është bërë përshkrimi i gjendjes faktike të punës së drejtorëve të shkollave, suksesit të nxënësve etj.

- **Metoda statistikore**, kemi paraqitur të dhëna statistikore.

- **Metoda descriptive**, kemi përshkruar rezultatet e hulumtimit.

- Intervista me drejtorin dhe drejtoreshën

- Pyetsore me arsimtar (60 mësimdhënës)

- Pyetsor me nxënës(200 nxënës)

- Pyetsor me prindër(200 prind)

K R E U IV

4.1.ANALIZA E Të DHËNAVE

4.2.Shkolla fillore “Naim Frashëri”-Tetovë

Shkolla me punë të rregullt mësimore ka filluar në vitin 1969. Në fillim objekti i shkollës i ka plotësuar nevojat e përgjithshme për mbajtjen e mësimit të rregullt, por me kohë, për shkak të migracionit të madh të popullësisë në rajonin e shkollës, ajo me kohë është ballafaquar me mungesën e lokalit dhe me numrin e madh të nxënësve.

Në vitin 2009 me donacion të firmës “Ecolog” u bë renovimi i tërësishëm i objektit të shkollës dhe i tereneve sportive, parkingut dhe rrethojës së oborrit.

Me këtë shkolla fitoi një pasqyrë krejt tjetër duke u mundësuar nxënësve dhe arsimtarëve punë në kushte normale. Vitin shkollor 2012/2013 shkolla fillore “Naim Frashëri” do ta fillojë me këtë numër të paraleleve dhe të nxënësve.³⁸

³⁸ www.tetovo.gov.mk

4.3.Shkolla fillore ‘Liria’-Tetovë

Për popullatën shqiptare në këto anë mësimi në gjuhën shqipe ka filluar qysh gjatë luftës së dytë botërore. Pas kësaj lufte, poashtu vazhdoi mësimi në gjuhën amëtare në shkollat fillore.

Që nga 1 Marsi i vitit 1945 në këtë vend ku ende nuk ishte ndërtuar objekti i shkollës u hap shkolla fillore me emrin "Liria" ku nxënësit mësonin në objekte të vjetra të ngelura nga medreset e kaluara.

Në këtë kohë numri i nxënësve arrinte shifrën 1085 nxënës prej atyre 579 meshkuj dhe 506 femra.

Në këtë vit shkollorë ishin të angazhuar 6 mësues (Gani Jahja, Hikmet Kasapi, Ahmet Haxhi Hasani, Burhan Muhedini, Zija Sadikudhe, Hyreme Tresi).Drejtori i shkollës ka qenë Vehap Kadriu. Vlen të përmendim kontributin e madh të mësuesve nga Shqipëria që vepronin në këtë shkollë gjatë kësaj periudhe si p.sh. Abedin Faja – Elbasan, Zija Zendeli- Dibër. Në grupin e këtyre mësuesve Polluqi-Elbasan, Hasan Teteli – Korçë, Zija Zendeli – Dibër.

Në grupin e këtyre mësuesve vepronin edhe dy mësues nga Tetova dhe ata ishin Vehap Kadriu dhe Xhevahir Veseli. Në vitet e ardhëshme shkollore numri i nxënësve nuk ka qenë stabil edhe pse gjithnjë shkonte në rritjen e tij.

Objekti i sotëm shkollor u ndërtua në vitin 1948-1949 në të cilin filloi mësimi me 28.02.1950. Puna vijohej në 22 paralele dhe me 1197 nxënës. Këtë proces e realizonin 23 mësues. Në vitin 1950-1952 në këtë objekt ka punuar edhe normalja e parë Shqipe e cila më vonë u transferua në Shkup.

Në vitin shkollor 1958-1959 qeveria e atëhershme bëri disa reforma dhe urdhëroi që në këtë objekt të mësojnë edhe nxënësit maqedonas. Prej asaj kohe deri më sot mësimi zhvillohet në gjuhën Shqipe dhe në gjuhën Maqedone. Gjatë kësaj periudhe 63 vjeçare sukseset e punës nuk kanë munguar. Përveç punës normale në këtë objekt shkollor pas luftës së dytë botërore janë mbajtur edhe kurse me të rritur për zhdukjen e analfabetizmit.

Në sukseset e mëdhaja të arritura vlen të përmendim veprimin aktiv të grupit të dramës që mori shumë shpërblime gjatë vitit shkollor 1959-1960 të udhëhequr nga arsimtari Seid Musai.

Poashtu në këtë shkollë veproi edhe kino klubi i vetëm në shkollat e Tetovës që pati rëndësi të madhe në zhvillimin e procesit edukativo arsimor. Sa për ilustrim gjatë vitit shkollor 1959-1960 janë dhënë 284 filma arsimorë dhe 35 filma artistik.

Mësuesit e kësaj shkolle bashkë me disa vullnetarë të qytetit në këtë ndërtesë shkollore e krijuan shoqërinë kulturo- artistike "Xheladin Zeqiri" që veproi rreth katër dekada duke i ngritur lartë vlerat kulturore me anë të këngëve dhe valleve shqiptare të kësaj ane.


Dhe në këtë vit shkollor 2012/2013 në shkollën fillore Liria - Tetovë ka gjithsejt 1068 nxënës prej të cilëve 780 shqiptarë dhe 274 maqedonas të shpërndarë në 24 paralele prej kl. së I e deri në kl. e VIII me gjuhë mësimore shqipe dhe në 16 paralele prej kl. së I e deri në kl. e VIII me gjuhë mësimore maqedonase dhe në dy paralele të kombinuara të nxënësve me nevoja të veçanta me gjuhë mësimore shqipe. Sot shkolla numëron gjithsejt 74 punëtorë edhe atë 64 mësimdhënës, 4 administratorë (drejtori, psikolog, pedagogu, sekretari) dhe 6 personel teknik.³⁹

³⁹ www.tetovo.gov.mk

4.3.REZULTATET E ANKETAVE –

4.3.1 ANKETAT E ARSIMTARËVE

Cka sjell ndryshimi I drejtorit në shkollën tuaj?




Drejtori i shkollës:

- përcakton vizionin e shkollës;
- siguron që personeli të jetë i motivuar për t'i përmbushur synimet dhe objektivat e shkollës;
- bashkëpunon me personelin e shkollës;
- është përgjegjës për zhvillimin e personelit;
- mbështet praktikatat e mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore
- ofron mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit.

Drejtorët e shkollave janë përgjegjës për të planifikuar, administruar, organizuar dhe menaxhuar shkollën, duke i shfrytëzuar me efikasitet dhe efektivitet mjetet në dispozicion. Duke punuar me secilin, drejtori i shkollës mundëson bashkëpunimin me bashkësinë dhe pjesëmarrjen në rritjen e cilësisë së të mësuarit dhe të suksesit të nxënësve. Ata i hartojnë dhe i zbatojnë politikatat në nivel shkolle dhe ato në nivel kombëtar për të siguruar zbatim të suksesshëm të krrikulumit kombëtar

Si e vlersoni punen e drejtorit ne Shkollen tuaj ??

■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4




Shumica nga arsimëtarët janë të kënaqur dhe vlersojnë pozitivisht punën e drejtorit.

- Drejtor me model formal(sjelljet zyrtare janë përparsi,)
- Drejtor me model kulturor(tradita të përbashkta)
- Drejtor me model politik(pasiqë ka vlersime të ndryshme brenda antarëve).

Edhe pse arsimëtarët e mirë i bëjnë kushtet e përshtshme për mësimëdhënie të mirë , këtu 8% e arsimëtarëve mendojnë që shkolla nuk ka kushte të volishme për punë .

Cili eshte problemi kryesor I Shkolles tuaj ??


■ Menaxhimi I Drejtorit ■ Kushtet e punws ■ Mos interesimi I Prindwrve ■ Sistemi Cambridge



Shumica mendojnë që Sistemi Camrdige është problem kryesor i Shkollës , pasi që për implementimin e këtij sistemi ka nevojë për hapësira më të mëdha , për laboratore moderne dhe paralele me numër më të vogël të nxënësve.

Si I menaxhoni problemet qe mund te dalin gjate punes tuaj ??

■ Drejtorin ■ Pedagogun ■ Psikologun ■ Me tw gjithw 15




Shumica e Arsimëtarëve problemin e ndajnë me Kolektivin

(Drejtor,Pedagog,Psikolog , Arsimëtarë).

Ae raportoni cdo pune te drejtori ?


■ PO ■ JO ■ Mvaret



Ky rezultat tregon dukshëm se drejtori nuk është i stilit autokrat , pasi që më shumë se gjysma nuk e raportojnë punën tek drejtori ose disa e raportojnë në disa raste.

Si e vlereson punen tuaj drejtori ?


■ Nw aspektin Metodologjik
 ■ Nga kwndwvshtrimi I komunikimit mw nxwnwsit
 ■ Nw aspektin e dijnsw



Arsimëtari duhet të ketë aftësi pedagogjike dhe metodologjike . Duhet të jetë në hap me kohën dhe duhet të jetë në vazhdimësi me plan programet e reja .

Si merren vendimet ne Shkollen tuaj ?


■ Vendimet I merr vet Drejtori ■ Vendimet merren bashkw nw Kolektiv



Ky rezultat tregon se Drejtori ka një bashkëpunim të thellë me kolektivin e Shkollës. Drejtori në këtë rast mund të thuhet se është Demokrat dhe i hapur për tërë kolektivin.

Sa eshte e pajisur Shkolla e juaj per ti plotesuar kushtet dhe nevojat e nxenesve per te zhvilluar procesin arsimor ??


■ Shkwlqyer ■ Shumw Mirw ■ Mirw



Shumica mendon se shkolla plotëson dhe ka kushte elementare për rrjedhje të pandashme të procesit arsimor , në krahasim me shkollat tjera në qytetin e Tetovës.

Drejtori i Shkolles tuaj eshte ?


■ Autokrat ■ Demokrat ■ ■



Shumica dërmuese e kolektivit mendon se drejtori është demokrat , dhe i hapur për cdo problem apo bashkëpunim . Kjo tregon që drejtori sheh përpara , tregon një vizion, organizon punën në bashkësi dhe është në pajtueshmëri me mendimet që vijnë nga jashtë.


Sistemi apo formati I menaxhimit te Shkolles a eshte shtytes per suksesin tuaj ?

■ PO ■ JO




Kjo tregon që menaxhimi është shtytës i suksesit të mësime dhënësve , pasi që drejtori ka krijuar një mjedis pune ku anëtarët e shkollës mund të punojnë me aftësitë e tyre më të mirë , të mendojnë me kreativitet dhe të shfrytëzojnë imagjinatën , të kenë motiv pune , të punojnë me karaktere të ndryshme etj.

4.5.Rezultatet e anketës tek pyëtsori për nxënësit :




Shumica e nxënësve e njef dhe dinë se kushë është drejtori , pasi që ka qenë arsimtari i tyre para dy viteve .




Nxënësit e shohin dukshëm ndryshimin e Shkollës pasi që ata kanë një sërë kërkesash nga shkolla ku e kalojnë një të tretën e ditës së tyre në Shkollë.

Si e vleresoni punen e drojtorit ne Shkolle? Prej 1 deri 5



Shumica e nxënësve mendojnë se drejtori e kryen punën në mënyrë të shkëlqyeshme.


A mendoni se Drejtori kujdeset per ju ?



Gjithashtu shumica dërmuese e nxënësve mendojnë se drejtori i tyre kujdeset për ata.

A mendoni se shkolla ofron te gjitha mundesite apo kushtet qe ju ta keni sa me lehte ?

PO JO Jo edhe aq shumw




S

70% i të anketuarve mendojnë se shkolla plotëson kushte për rjedhje normale të mësimi , që ata ta kenë sa më të lehtë.

Gjate oreve qe qendroni ne hapesirat e shkolles a e ndjeni vehten e lire dhe a kenaqeni ?


PO JO Nw disa raste



Shumica mendon se ka rahat dhe janë të lirë në hapësirat e shkollës në suaza të gjërave të lejuara .

Gjithashtu përgjigje interesante nga nxënësit , ku deri në 96% i tyre duan dhe mendojnë të bëhen drejtor po sikur drejtori i shkollës së tyre.

Kur te riteni a pretendoni te beheni drejtor Si drejtori i jauj ?



ANALIZA E PYETJES Së DYTë (te pyetsori i nxënësve)SIPAS KëNDVëSHTRIMIT Të ANA FROJD?

Pyetja?-

Vizato Drejtorin :

Ana Frojd thekson se cdo vizatim i fëmijëve në vete përban një esse psikologjike .Qëllimi im me parashtrimin e kësaj pyejtje ishte që pyeëtsori i fëmijëve të jetë më interesant dhe më atraktiv . (Ja arrita) !

Fëmijët e moshës 13-14 vjecare , vizatuan drejtorin në disa forma , ku shumica kanë potencuar sytë dhe flokët . Disa nga këto , vizatimin e kanë vizatuar në skaj e disa në mes qe do të thotë se fëmijët me vetëbesim të plotë , kanë vizatuar një vizatim më të plotë dhe në mes të kutisë , kurse ata me karakter të mbyllur kanë vizatuar drejtorin me emocione ose me shkrim , duke shkruar “ Shkëlqyeshëm “.

Vizatimi i kokës me përmasa të mëdha apo në masa shumë të vogla , është tregues i problemeve mendore gjatë aktiviteteve , në rastëse vizatohen organe të trupit të njeriut apo lehen pjesë të zbrazta të trupit, mund të jetë tregues për problemet që ndjen fëmija po në ato pjesë të cilat nuk i ka vizatuar.Vizatimi i duarve në forma gjigjande mund të jetë tregues se fëmija është pjesë e ushtrimit të dhunës familjare apo direkt i dhunës në familje.

REZULTATET PER DREJTORIN (pyetja e dytë te pyetsori i nxënësve)

- Vërehet
- Ikapshëm
- I lirë
- Vëzhgues
- I dallueshëm
- I lumtur
- I afert menxënësit

Vizatimi i gojës në formë të madhe tregon probleme me shprehjen e fëmijës , ose në rastë se nuk vizatohet aspak goja kjo tregon se fëmija ka probleme serioze gjatë komunikimit dhe shprehjes me tjerët.


Vizatimi i hundës në formë gjigjande është tregues i problemeve me organet e frymemarjes, ka bronhit ose astma .

Vizatimi i veshëve në formë të madhe mund të reflektoj ose tregoj se fëmija ka probleme me dëgjimin .

4.6.Rezultatet e Anketave të pyetsorit për Prindërit e Nxënësve ?

A jeni te kenaqur nga kushtet e shkolles ku meson femija i juaj ?


■ PO ■ JO ■ Nw disa raste



Shumica e prindërve mendojë se shkolla plotëson të gjitha kushtet .

Si e shihni drejtorin e shkolles ?


■ Drejtor meambicje të larta ■ Drejtor i suksesshëm



Disa prindër mendojnë se drejtori ka ambicija të larta, ndërsa shumica e tyre mendojnë se drejtori është i suksesshëm në punën që kryen.

A mendoni se respektohen dhe mbrohen te drejtat e femijes tuaj nga shkolla dhe mesimdhenesit ?


PO JO Jo cdo herw



64% e prinerve mendojë se fëmijët e tyre janë të mbrojtur nga mësimdhënësit dhe kanë rehati në shkollë , një përqindje e vogël mendon se nuk kanë , gjë që duhet shqyrtuar dhe diskutuar nga drejtorja dhe kolektivi me prindërit e brengosur.

Si e vleresoni punen e drejtorit ne shkolle ? Prej 1 deri 5


1 2 3 4 5



Si nxënësit edhe shumica dërmuese e prindërve mendon se drejtori e kryen punën me sukses të lartë .

A mendoni se nxenesit diskriminohen ne baze nacionale , fetare apo ekonomike ?


■ PO ■ JO



Shumica e prindërve mendojnë se nxënësit nuk diskriminohen , por numri i atyre që mendojnë se fëmijët e tyre janë të diskriminuar në baza nacionale , fetare apo ekonomike është i lartë , gjë që shqetëson , por duhet hulumtuar se nga kush dhe në cfar forma diskriminohen fëmijët .

A mendoni se mesimdhënesit i vlersojne nxenesit ne nivel te duhur dhe menyre te drejte ?


■ PO ■ JO



66% i prindërve mendojnë se mësimdhënësit vleërsojnë dhei notojnë në mënyrë të drejtë fëmijët e tyre .

Ne sa raste keni biseduar me drejtorin ?

■ Nw shumw raste ■ Nwdisa raste ■ Aspak ■ Nuk e di kush wshtw Drejtor



Shumica e prindërve preferojnë që problemet e fëmijëve ti zgjedhin me kujdestarin apo mësuesin e tyre , duke mos patur nevojë për bisedë me drejtorin.

4.7.INTERVISTA ME DREJTORIN (Xhelal Alili)

1. I nderuari drejtor.

Ju lutemi përshkruani auto-biografinë tuajë ne pika të shkurta?

- Shkollën fillore e kamë kryer në këtë shkollë , të mesmen drejtimin e komunikacionit gjatë viteve 1973-1977 , Akademinë Pedagogjike 1978-80 dhe Shkencat Politeknike në Shkup 1981-84 , si dhe vitin 2009 në Manastir fakultetin e Inxhinjerisë informatike . Jamë trajnues për softëare'in EMIS-HRM apo ditarin elektronik i cili zbatohet në të gjithë arsimin në Maqedoni (Kjo është vetëm një pjesë e punës time)

2. Sa kohë keni punuar si arsimtarë?

34 Vite kamë punuar si arsimëtarë i Shkencave (Bazat e arsimit teknik)

3. Tash më sa kohë kanë kaluar që jeni drejtorë?

2 vite

4.Sa paralelegjegjesisht sa klasa dhe nxënës udhëhiqni ju si drejtorë shkolle?

57 paralele- klasa

4. Cka ndryshoi më shumë me kalimin nga arsimtarë në drejtorë shkolle?

Ndryshova qëndrimin , ndryshova veten që të ndryshoj punët në Shkollë.

5. Cila ishte puna e parë që realizuat për shkollën ?

Ngritjen e suksesetit si dhe ofrimin e kushteve për punë.

6. Si e vlerësonin suksesin gjegjësisht mësimdhënjen e arsimtarëve/mësuesve në shkollën tuaj ?

Në nivel të mirë , por synojmë edhe më lartë.

7. Si qëndron bashkëpunimi juaj mes kolegëve ?

Shkëlqyeshëm

8. Cfar kushte ofron shkolla për të patur sukses arsimtarët/mësuesit

Që në fillim të mandatit jamë zotuar se do të ofroj kushte pune që të arrijmë deri tek suksesi. Mjete pune për të gjitha lëndët , LCD Proektor , printera , rrjet ël-FI në të gjitha hapësirt e Shkollës

9. A keni laborator dhe të njetat a janë në funksion ?

Jo nuk posedojmë laboratore , por kemi hartuar plane që tua mundësojmë nxënësve edhe labororet (Hapësirat e bëjnë të veten)

10. Cili është problem kryesor i shkollës ?

Kushtet hapsinore , salla e sportit dhe mos pasja e laboratoreve për lëndët natyrore.

11. Si I menaxhoni problemet që munde të dalin gjatë punës ? I zgjidhni vet apo kërkonin dihmë nga pedagogu dhe psikologu?

Si staf punojmë në formë ekipore.

12. A e raportoni punën tuaj te kolegët ? cfar drejtori jeni autocrat apo democrat?

Për cdo ditë në mëngjesë , raportojmë për punët e bëra dhe aktivitetet e tjera ditore dhe më gjërë.

13. Po bashkepunimi me prindërit. A keni këshillin e prindërve ?

Po funksionon dhe cdo vendim që meret me ta është konform ligjeve .

14. Sa degjohen dhe sa plotësohen kërkesat dhe sugjerimet e prindërve?

Cdo herë jemi të hapur për sugjerime .

15. Sa respektohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve nga shkolla dhe mësime dhënisit?

Sigura? Gjithshcka që parasheh ligji.

16. Dukë marë parasyshë se edhe ju keni qenë arsimtarë a mendoni se sistemi aktual i

Cambridge është më i mirë dhe i dobishëm se ai më parë?

Sistemi Cambridge për mendimin timë , është më i mirë dhe më i dobishëm se sistemi i mëparshëm , por për realizimin e këti sistemi është dashur të harmonizohen programet shkollore .

17. A mendoni se arsimit në maqedoni është duke shkuar rrugës së duhur apo duhet ndryshme rrënjësore?

Duhet të ketë ndryshime rrënjësore , nga posht lartë.

18. Cka do të kishit ndryshuar në shkollën tuaj për të pasur më shumë sukses?

Kushte hapësionre dhe mjete punë më bashkëkohore

19. Cka është misioni i shkollës tuaj ?

Një Shkollë e hapur për të gjithë.

20. A funksionon sistemi drejtues i shkollës?

Po , vendimet meren në formë kolektive

21. Kur pranuat postin drejtor, ku ishte shkolla? Ku është dhe ku nga po shkoni ?

Ishte në situatë të mirë , por qëllimi dhe synimi i imi është të bëhet edhe më mirë , duke foëruar mjete dhe kushte për punë si dhe duke trajnuar stafin në të gjitha lëmitë , kurse nxënësve tu ngjesim frymë garuese në shkollë dhe jashtë shkollës.

22. Ju si drejtor i suksesshmë dhe me plot përvoj cka do të kishit sugjeruar për ata që kanë synime të bëhen drejtorë?

Të jenë të vendosur , të kenë ambicie për punë dhe të jenë vizioner me ndryshimet që vijnë dhe gjithashtu të evaluojnë me kohën.

4.8. ANALIZA E TË DHËNAVE NGA INTERVISTA E DREJTORIT

Nga ajo që u prezantua në këtë shkrim, vijmë në për fundim

- Drejtori i shkollës formon një vizion të suksesit akademik për të gjithë në baze të standardeve të larta;
- Krijon një klimë miqësore për arsimin në mënyrë sa më të sigurt,
- Kultivimi i udhëheqjes të tjerët në mënyrë që mësuesit dhe nxënësit të marrin pjesë në realizimin e vizionit të shkollës së tyre.;
- Përmirësimi i udhëzimeve për t'u mundësuar mësuesve të mësojnë gjërat që duhen përmirësuar në të ardhmen;
- Menaxhimin e njerëzve, të dhënat dhe proceset për të ushqyer përmirësimin e shkollës.
- Krijon kushte sa më të mira sipas mundësive që të arihet sukcesi i shkollës.
- E raporton çdo ditë punën e bërë dhe diskutohet ajo që duhet të bëhet.
- Funkcionon Këshilli i prindërve
- Vendimet në shkollë merren në formë kolektive.
- Këshilli shkollor është konstituuar në përputhje me rregullativën dhe


Statutin e shkollës.

- Këshilli shkollor ka rregullore për punë.
- Këshilli shkollor bashkëpunon me organin udhëheqës të shkollës dhe me struktura të tjera arsimore vetëm në nivel formal
- Drejtori posedon menaxhimin strategjik(financiar)
- Drejtori posedon menaxhim organizativ
- Drejtori posedon menaxhim operacional
- Drejtori bën planifikime afatgjate
- Drejtori ka definuar politikat strategjike të shkollës – vizioni, misioni, qëllimi, objektivat.

4.9.REZULTATET E ANKETAVE – sh.f.”Liria”

4.10.ANKETAT E NXËNËSVE


Cka sjell ndryshimi I drejtorit në shkollën tuaj?



Drejtoresha e shkollës:

- përcakton vizionin e shkollës
- motivon personelin
- bashkëpunon me personelin e shkollës;
- është përgjegjës për zhvillimin e personelit;
- mbështet praktikat e mësimdhënies dhe mësimnxënies cilësore
- ofron mundësi të barabarta për të gjithë nxënësit
- mbështet metodat e reja në mësimdhënie


Si e vlersoni punen e drejtorit ne shkollen tuaj ??



- Asimtarët janë të kënaqur nga puna e drejtoreshës

Edhe pse arsimëtarët e mirë i bëjnë kushtet e përshtatshme për mësimëdhënie të mirë , këtu 3% i arsimëtarëve mendojnë që shkolla nuk ka kushte të volitëshme për punë .


Cili eshte problemi kryesor i Shkolles tuaj ??



Shumica mendojnë që Sistemi Cambridge është problem kryesor i shkollës , pasi që për implementimin e këtij sistemi ka nevojë për hapësira më të mëdha , për laboratore moderne dhe paralele me numër më të vogël të nxënësve.

Si i menaxhoni problemet qe mund te dalin gjate punes tuaj ??

■ Drejtorin ■ Pedagogun ■ Psikologun ■ Me tw gjithw 15




Shumica e Arsimëtarëve problemin e ndajnë me Kolektivin

(Drejtor,Pedagog,Psikolog , Arsimëtarë).

Ae raportoni cdo pun te drejtoresha ?


■ PO ■ JO ■ Mvaret ■ 4th Qtr



Ky rezultat tregon dukshëm se drejtoresha nuk është i stilit autokrat , pasi që më shumë se gjysma nuk e raportojnë punën tek drejtoresha ose disa e raportojnë në disa raste.

Si e vlereson punen tuaj drejtoresha ?


- Nw aspektin Metodologjik
- Nga kwndvwwshtrimi I komunikimit mw nxwnwsit
- Nw aspektin e dijnsw
-



Arsimëtari duhet të ketë aftësi pedagogjike dhe metodologjike . Duhet të jetë në hap me kohën dhe duhet të jetë në vazhdimësi me plan programet e reja .

Si merren vendimet ne shkollen tuaj ?

- Vendimet I merr vet Drejtori
- Vendimet merren bashkw nw Kolektiv
- 4th Qtr



Ky rezultat tregon se drejtoresha ka një bashkëpunim të thellë me kolektivin e shkollës. Drejtoresha në këtë rast mund të thuhet se është demokrate dhe e hapur për tërë kolektivin.

Sa eshte e pajisur shkolla juaj per ti plotesuar kushtet dhe nevojat e nxenesve per ti zhvilluar procesin arsimor ??


■ Shkwlqyer ■ Shumw Mirw ■ Mirw ■



Shumica mendon se shkolla plotëson dhe ka kushte elementare për rrjedhje të pandashme të procesit arsimor , bazuar në krahasim me shkollat tjera në qytetin e Tetovës.

Drejtoresha e Shkolles tuaj eshte?


■ Autokrat ■ Demokrat ■ Drejtori I Shkollwstuwaj wshtw ??



Shumica dërmuese e kolektivit mendon se drejtoresha është demokrat , dhe e hapur për cdo problem apo bashkëpunim . Kjo tregon që drejtoresha sheh përpara , tregon një vizion, organizon punën në bashki dhe është në pajtueshmëri me mendimet që vijnë nga jashtë.

Sistemi apo formati i menaxhimit te Shkolles a eshte shtytes per suksesin tuaj ?

■ PO ■ JO ■ 4th Qtr



Ky rezultat tregon që menaxhimi është shtytës i suksesit të mësimdhënve , pasi që drejtoresha mundohet të krijojë një mjedis pune ku arsimtarët dhe mësuesit e shkollës mund të zbatojnë një mësimdhënie më të mirë ,më efikase dhe më bashkohore.

4.11.Rezultatet e anketës tek pyëtsori për nxënësit :




Nxënësite e njohin nga afër drejtoreshën.




Nxënësit e shohin dukshëm ndryshimin e shkollës pasi që atakanë një sërë kërkesash nga shkolla ku e kalojnë një të tretën e ditës së tyre në shkollë.

Si e vlerwsoni punwn e drojtorit nw Shkollw? Prej 1 deri 5




Shumica e nxënësve mendojnë se drejtori e kryen punën në mënyrë të shkëlqeshme.

A mendoni se drejtoresha kujdeset per ju ?




Gjithashtu shumica dërmuese e nxënësve mendojnë se Drejtori i tyre kujdeset për ata.

A mendoni se shkolla ofron te gjitha mundesite apo kushtet qe ju ta keni sa me lehte ?



Vetëm 10% i të anketuarve mendojnë se shkolla plotëson kushte për rrjedhje normale të mësimi, që ata ta kenë sa më lehtë, kurse shumica mendojnë që shkolla NUK posedon kushte të mira.


Gjate oreve qe qendroni ne hapesirat e shkolles, a e ndjeni te lire dhe a kenaqeni ?



Gjysma mendon se ka rahat dhe janë të lirë në hapësirat e Shkollës në suaza të gjërave të lejuara, disa mendojnë qëka në vetëm disa raste.


Kur te riteni a pretendoni te beheni drejtor si drejtoresha jauj ?

■ PO ■ JO ■ ■




Vetëm 69 % i nxënësve pretendojnë të bëhen si drejtoresha!

5.3.3 Rezultatet e Anketave të pyetsorit për Prindërit e Nxënësve ?




Shumica e prindërve mendojë se shkolla plotëson të gjitha kushtet .



Disa prindër mendojnë se drejtoresha ka ambicji të larta, ndërsa shumica e tyre mendojnë se drejtoresha është e suksesshme në punën që kryen ajo.

A mendoni se respektohen dhe mbrohen te drejtat e femijes tuaj nga shkolla dhe mesimdhenesit ?


■ PO ■ JO ■ Jo cdo herw ■



50% e prindërve mendojnë se fëmijët e tyre janë të mbrojtur nga mësimëdhënësit dhe kanë rehati në shkollë , një përqindje tjetër mendon se nuk kanë , gjë që duhet shqyrtuar dhe diskutuar nga drejtorja dhe kolektivi me prindërit e brengosur.

Si e vleresoni punen e drejtoreshes ne shkolle ? Prej 1 deri 5


■ 1 ■ 2 ■ 3 ■ 4 ■ 5



Si nxënësit edhe shumica dërmuese e prindërve mendojnë se drejtoresha e kryen punën me sukses të lartë .

A mendoni se nxenesit diskriminohen ne baze nacionale , fetare apo ekonomike ?


■ PO ■ JO ■ ■



Shumica e prindërve mendojnë se nxënësit po diskriminohen.

A mendoni se mesimdhenesit i vlersojne nxenesit ne nivel te duhur dhe menyre te drejte ?


■ PO ■ JO ■ ■



66% i prindërve mendojnë se mësimdhënësit vlersojnë dhe notojnë në mënyrë të drejtë fëmijët e tyre .

Ne sa raste keni biseduar me drejtoreshen ?

■ Nw shumw raste ■ Nwdisa raste ■ Aspak ■ Nuk e di kush wshtw Drejtor



Shumica e prindërve preferojnë që problemet e fëmijëve ti zgjedhin me kujdestarin apo mësuesin e tyre , pa mos patur nevojë për bisedë me drejtoreshën.

4.12.INTERVISTA ME DREJTORESHËN (Shpresa Iseini)

1.Ju lutemi përshkruani auto-biografinë tuajë ne pika të shkurta?

Shkollën fillore e kam kryer në shkollën fillore “Istikball”, të mesmen e kam vazhduar në shkollën e mjekësisë “Nikolla Shtejn” në Tetovë, pasi dëshira ime e madhe ishte të studioj gjuhën dhe letërsinë shqiptare, në vitin 1997 regjistrova fakultetin filologjik dega-” Gjuhë dhe letërsi shqipe” në Shkup.

Pas mbarimit me sukses të fakultetit përvojën e parë si arsimtare e morra në shkollën fillore “Sabedin Bajrami” në fshatin Kamjan, më pas kam punuar si profesoreshë në shkollën e mesme ekoomike “8 Shtatori” në Tetovë dhe pas përfundimit të kontratës me kohë të caktuar që kam qenë në shkollën ekonomike u pranova në shkollën fillore “Liria” në Tetovë si arsimtare e gjuhës shqipe, ku edhe sot e kësaj dite punoj por si drejtoreshë e kësaj shkolle,

2.Sa kohë keni punuar si arsimtarë?

13Vite si profesoreshë

3.Tash më sa kohë kanë kaluar që jeni drejtorë?

4 vite e gjysëm.

4.Sa paralelegjegjësisht sa klasa dhe nxënës udhëhiqni ju si drejtorë shkolle

35 Klasa

1170 Nxënës

3 paralele me nevoja të posacme

5.Cka ndryshoi më shumë me kalimin nga arsimtarënë drejtorëshkolle?

Përgjegjësitë janë më të mëdha dhe njohja për së afërmi me menaxhimin e një institucioni.

6. Cila ishte puna e parë që realizuat për shkollë?

Janë bërë shumë punë për shkollën,puna e parë pasi e morra postin e drejtorit është që bëra nacionalizimin e objektit dhe vendin e shkollës.

7.Si e vlersonin suksesin gjegjësisht mësimdhënien e arsimtarëve mësuesve në shkollën tuaj?

Gjatë vëzhgimit të orëve mësimore që kam bërë e vlersoj se është në nivelin e duhur të mësimdhënies bashkekohore.

8.Si qëndron bashkëpunimi juaj me kolegëve ?

Bashkpunimi është transparent dhe në nivelin e duhur

9. Cfar kushte ofron shkolla për të patur sukses arsimtarët/mësuesit

Me ato mjete që na i lëshon MASH dhe me projektet me të cilëat punon shkolla mundohemi që të jenë kushtet sipas standardeve të cilat i këkron procesi edukativo-arsimor.

10.A keni laborator dhe të njetat a janë në funksion ?

Kemi kabinet për informatik dhe është në funksion,ndërsa laorator nuk kemi!

11.Cili është problem kryesor i shkollës ?

Problemi kryesor është (hapsira)-të kemi më shumë kabinete nga të gjitha lëndët.

12.Si I menaxhoni problemet që munde të dalin gjatë punës ? I zgjidhni vet apo kërkonin ndihmë nga pedagogu dhe psikologu?

Problemet gjithmonë zgjidhen së bashku me puntorët,profesion(pedagog,psikolog,prindër)

13. A e raportoni punën tuaj te kolegët ? cfar drejtori jeni autokrat apo demokrat?

Të gjitha punët në shkollë janë transparent raportohen para këshillit arsimor,këshillit të shkollës dhe këshillit të prindërve.(Jam demokrate)..

14.Po bashkëpunimi me prindërit. A keni këshillin e prindërve ?

Po kemi këshillin e prindërve,pa të cilin nuk mund të funksionojmë,dhe gjithmonë jemi dhe kemi përkrahjen e tyre.

15.Sa degjohen dhe sa plotësohen kërkesat dhe sugjerimet e prindërve?

Mendoj se dëgjohehen dhe respektohen më shumë kërkesat e tyre.

16.Sa respektohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve nga shkolla dhe mësime mësuesit?

Siguria?

Nxënësit janë gjithë më e shtrejt për ne dhe kuptohet fëmijët janë të mbrojtur në çdo aspekt nga çdo lloj i dhunës apo padrejtësisë

17.Cfar bëni për të motivuar mësime mësuesit ?

Lëvdatat dhe ndonjë ekskurzion janë motiv për punën e mësime mësuesve.

18.A i zbatoni metodat e reja bashkohore?Sa keni mundësi për të zbatuar?

I zbatojmë në bazë të kushteve që i kemi.

19.Duke marrë parasysh se edhe ju keni qenë arsimtarë a mendoni se sistemi aktual i Cambridge është më i mirë dhe i dobishëm se ai më parë?

Mendoj se mësimi klasik për dallim nga sistemi “cambridge” është më i suksesshëm,pasi që vet unë jam nga ai-ato nxënës që kemi pasur mësim më cilësor dhe të pavarur.

20..A mendoni se arsimi në Maqedoni është duke shkuar rrugës së duhur apo duhet ndryshme rrënjësore?

Duhet të ketë ndryshimë rrënjësore , nga posht lartë.

21.Cka do të kishit ndryshuar në shkollën tuaj për të pasur më shumë sukses?

Po të kem mundësi do të bëja ndryshimin e orarit të nxënësve që është i stërngarkuar ,më shumë do i jepja rëndësi mësimit hulumtues dhe ngritjen e vetëdijes,sepse Arsimi është shtylla kryesore e një populli

22.Cka është misioni i shkollës tuaj ?

Misioni ynë është të kemi kushte ende më të mira për një mësim bashkohor evropian dhe më tepër ti jepet rëndësi mësimxënies e jo letrave formale.

23. A funksionon sistemi drejtues i shkollës?

Po funksionon sepse pa të nuk do të kishim këtë institucion edukativo-arsimor.

24. Kur pranuat postin drejtor, ku ishte shkolla? Ku është dhe ku nga po shkoni ?

Kur pranova postin e drejtorit e gjeta shkollën me catinë e dëmtuar, e cila ka afër 70 vite nga ndërtimi, dyert ishin të vjetra, shkallët e shkatëruara, dyshemet e klasave ishin shumë të vjetra. Ndërsa tani të gjitha këto janë riparuar, por kjo ende nuk është e mjaftueshme. NE do të vazhdojmë me punën deri sa të arihet synimi i paraparë

25. Ju si drejtor I suksesshmë dhe me plot përvoj cka do të kishit sugjeruar për ata që kanë synime të bëhen drejtorë?

Të kenë parasysh se kur meret ky post duhet të definohet misioni dhe vizioni që ia vendos vetes dhe ta bëjnë me përkushtimin më të madh, pasi që të menaxhosh është detyrë e rëndë dhe me përgjegjësi të madhe morale e njerzore.

4.13.Nga intervista me drejtoreshën, konkludojmë:

Ka njohuri te perditësuar dhe aftesi për:

- a) hartimin e vizionit, të planit afatmesem dhe të planit vjetor të institucionit
- b) menaxhimin financiarë të institucionit;
- c) hartimin e projekteve.

Ne bashkëpunim me personelin e institucionit, nxënësit e prinderit e tyre, menaxhon hartimin dhe zbatimin e:

- rregullores së institucionit dhe të rregullores së etikës dhe të sjelljes në institucion;
- procedurave mbi ushtrimin e së drejtës së nxënësve dhe të prindërve për t'u informuar mbi veprimtarinë e institucionit dhe të punonjësve të tij;
- nje plan të posacëm për mbrojtjen e nxënësve nga droga, alkooli e duhani;
- nje plan të posacëm mbi aktivizimin e nxënësve në veprimtarinë kulturore, sportive dhe argëtuese.

Menaxhon analizat sistematike te cilësisë së shërbimit të institucionit ndaj nxënësve duke u bazuar në:

- nje sistem treguesish sasiorë dhe cilësorë të monitorimit dhe vlerësimit të veprimtarive të institucionit dhe posacerisht të arritjeve të nxënësve;
- objektivat e planit vjetor;

Drejtoresha

1) Ka njohuri te perditësuar dhe i demonstroi ato për:

- a. stilet dhe praktikat e komunikimit;
- b. metodat e negociimit, te zgjidhjes se konflikteve dhe te arritjes në konsensus.

2) Ka një vizion te qarte mbi cilesinë e shërbimit që institucioni duhet te ofroje i cili të jetë ne përputhje me vlerat demokratike, politikat kombetare, synimet e sistemit arsimor

Beson se secili mësimdhënës mundet te realizojë dhe te zhvillojë potencialin e tij.

- Ka parësor interesin e nxënësve.
- Ka parësor krijimin e një institucioni miqësor ndaj nxënësve;

- Respekton të drejtat dhe liritë e njeriut dhe, vecanërisht, te drejtat e fëmijëve dhe është i aftë të krijojë në institucion atmosferën ku respektohen këto të drejta.
- Eshte kunder cdo forme te diskriminimit te nxënësve, punonjesve te institucionit, prindërve etj dhe eshte e aftë te krijojë në institucion kulturën kundër cdo forme të diskriminimit.
 - Drejtoresha e shkollës Formon një vizion të suksesit akademik për të gjithë në baze të standardeve të larta;
 - Reflekton një klimë miqësore për arsimin në mënyrë sa më të sigurt,
 - Kultivimi i udhëheqjes te të tjerët në mënyrë që mësuesit dhe nxënësit të marrin pjesë në realizimin e vizionit të shkollës së tyre.;
 - Përmirësimi i udhëzimeve për t’u mundësuar mësuesve të mësojnë gjërat që duhen përmirësuar në të ardhmen;
 - Menaxhimin e njerëzve, të dhënat dhe proceset për të ushqyer përmirësimin e shkollës.
 - Krijon kushte sa më të mira sipas mundësive që të arihet suksesi i shkollës.
 - E raporton planin dhe punën e kryer në këshilla
 - Këshilli i prindërve është mjaft kryesorë në këtë shkollë
 - Vendimet në shkollë meren në formë kolektive.
 - Këshilli shkollor është konstituuar në përputhje me rregullativën dhe Statutin e shkollës.
- Këshilli shkollor ka rregullore për punë.
 - Këshilli shkollor bashkëpunon me organin udhëheqës të shkollës dhe me struktura të tjera arsimore vetëm në nivel form
 - Dejtoresha posedon menaxhimin strategjik(financiar)
 - Drejtoresha posedon menaxhim organizativ
 - Drejtoresha posedon menaxhim operacional
 - Drejtoresha bën planifikime afatgjate

1.14. REKOMANDIME PËR ARSIMTARËT

Çfarë mund të bëni për të krijuar një mjedis të personalizuar të të mësuarit? Këtu janë pesë rekomandime.

☐ Shfrytëzoni kohën për t'u njohur me nxënësit tuaj. Harxhimi i dy apo tre minutave në çdo javë duke folur me (apo duke dëgjuar) nxënësit individualisht, jep pjesë të mëdha të nga fitimet. Në qoftë se mendojmë një klasë prej 30 nxënësish, po flasim për të shpenzuar vetëm rreth një orë nga koha juaj për çdo javë duke u njohur me nxënësit tuaj. Përdorini këto bashkëbisedime për të kuptuar jetën në klasa nga pikëpamja e nxënësve.

☐ Krijoni kultura të klasës bazuar në një ndjenjë besimi, respekti dhe komunikimi të hapur. Brenda këtyre kulturave, punoni për të minimizuar kërcënimet e ndjenjave të kompetencës, pavarësisë dhe marrëdhënieve me të tjerë të rëndësishëm. Në qoftë se është e nevojshme, punoni që të ndryshoni perceptimin publik për shkollën dhe klasën, kështu që ata që vizitojnë shkollën, ta shohin mjedisin si mikpritës, dashamirës, të parrezikshëm dhe të drejtë.

☐ Punoni për të krijuar komunitete të të mësuarit. Një ndjesi e komunitetit ekziston kur një masë kritike e aktorëve, angazhohen ndaj njëri tjetrit dhe vlerave e objektivave të përgjithshme. Puna e tyre drejtohet nga përmbushja e qëllimit dhe ruajtja e marrëdhënieve pozitive dhe mbështetëse me njëri tjetrin. Ndërtimi i një ndjesie të komunitetit fiton kur nxënësit mbërrijnë në fitim në shkollë.

Komunitetet e të mësuarit shumë shpesh janë rezultat i përpjekjeve të drejtuara kah të gjithë sugjerimeve të tjera në këtë seksion. Domethënë një komunitet i të mësuarit ka të ngjarë më së shumti të jetë në vend kur ka të dhëna të personalizimit, drejtimit të objektivit, besimit, respektit të ndërsjellë, ndershmërisë dhe drejtësisë.

☐ Krijoni plane të personalizuara të ndihmës për nxënësit me nevojat më të mëdha. Këto plane nuk ka nevojë të jenë masive apo komplekse. Ato mund të përfshijnë diçka aq të thjeshtë sa ç'mund të jetë fakti që ju të shpenzoni disa minuta ekstra me një nxënësit të veçantë menjëherë pasi atij i është caktuar një punë individuale për t'u siguruar që nxënësi është në "brazdën e duhur".

☒ Shpesh herë puna me nxënës të veçantë është shumë e vështirë, për shkak të detyrave dhe përgjegjësi të tjera që ju keni si mësues. Kur ndodheni në një situatë të tillë, më e mira është të përcaktohen çështjet dhe problemet e përbashkëta për grupe nxënësish. Supozoni për shembull, që pesë apo shtatë nxënës kanë vështirësi me një detyrë të caktuar leximi. Ju mund të doni që të punoni me këtë grup të vogël dhe t'u mësoni atyre si ta analizojnë materialin, në mënyrë që t'i ndihmoni ta kuptojnë atë më mirë.

Me në fund, koncepti i komunitetit të të mësuarit mund të zgjerohet përtej shkollës dhe klasës, duke përdorur video konferencën, komunikimin me zë (si në një urë radiofonike), ose rrjetet sociale. Duke e zgjeruar konceptin e komunitetit të të mësuarit, nxënësit mund të bëhen të ndërgjegjshëm për mundësitë që janë përtej klasës së tyre dhe dyerve të shkollës.

1.15. REKOMANDIME PËR DREJTORËT E SHKOLLAVE:

Drejtori i shkollës është përgjegjës për gjithçka që zhvillohet në shkollë, duke filluar nga zbatimi i akteve ligjore, për cilësinë e zhvillimit të procesit edukativo-arsimor, bashkëpunimit me mësimdhënësit, nxënësit nga njëra anë dhe komunitetit nga ana tjetër.

Pra, thënë shkurt drejtori është përgjegjës i të gjitha veprimtarive në shkollë dhe pikërisht nga drejtori varet në masë shumë të madhe suksesi apo mos suksesi i ecursisë së tërë punës në shkollë.

Udhëheqësit e suksesshëm duhet të punojnë me prioritet, ngase prioritetet janë çelësi i udhëheqjes së suksesshme, shohin mundësi në çdo vështirësi, janë bashkëpunëtorë, i motivojnë të tjerët për punë, kanë vizion dhe kështu ata duke punuar në këtë formë i bënë që të jenë të suksesshëm.

Sipas Goleman ekzistojnë gjashtë lloje të udhëheqjes prej të cilave dy stile (lloje) që ndikojnë negativisht dhe katër të tjera që ndikojnë në mënyrë pozitive në krijimin e një klime të favorshme dhe në arritjet shkollore të nxënësve:

1. Stilin detyrues të udhëheqjes (“kërkon zbatim të urdhrit ose “bëni si të them unë”).
2. Stilin autoritar të udhëheqjes (“mobilizon njerëzit drejt një vizioni, ose “ejani me mua”).
3. Stilin bashkëpunues të udhëheqjes (“krijon harmoni dhe ndërton lidhje emocionale, ose “njerëzit para se gjithash”).
4. Stilin demokratik të udhëheqjes (“kalitë marrëveshjen përmes pjesëmarrjes, ose “si mendoni ju”).
5. Stilin përcaktues të ritmit (“cakton standarde të larta të punës, ose “bëni si bëjë unë, qysh në këtë çast”).
6. Stilin trajnues udhëheqës (“përgatit njerëzit për të ardhmen, ose “provoje këtë”)

“Sa më shumë stile që të ketë një drejtues, aq më mirë. Drejtuesi që zotëron katër ose më shumë – sidomos stilin autoritar, demokratik, bashkëpunues dhe trajnues – kanë atmosferë më të mirë dhe punët ju ecin mirë. Dhe drejtuesit më të frytshëm kalojnë, lehtësisht, nga njëri stil në tjetrin, sipas nevojës... Mësues të tillë nuk e përshtatin mekanikisht stilin e tyre, sipas një stili të caktuar rrethanash – ata janë shumë më të rrjedhshëm. Ata arrijnë të kuptojnë shumë mirë ndikimin që kanë mbi të tjerët dhe e përshtatin stilin në mënyrën e duhur, për të arritur rezultate më të mira

Me përmirësimin e vazhdueshëm të praktikave mësimore, udhëheqësit arsimor krijojnë dhe ofrojnë mundësi për shumë fëmijë që të përfitojnë dhe marrin njohuri, zhvillojnë shkathtësi esenciale për jetë, dhe qëndrime bazë për jetën e tyre.

Shkollat e suksesshme dhe edukimi cilësor arrihen si rezultat i menaxhmentit të përkushtuar në punë dhe cilësi. Nuk mund të ketë cilësi në shkollë pa udhëheqje dhe menaxhment cilësor dhe efektiv.

Udhëheqësit arsimor efektiv i ndihmojnë shkollat e tyre të përgatisin një vizion që përmban nivel të lartë të përkushtimit në mësimdhënie dhe mësimnxënie – si parakusht për arsim cilësor në shkollat e tyre.

Drejtorët e shkollave kanë rol të rëndësishëm në arritjen e cilësisë së mirë arsimore: Ata janë menaxherë të disa prej faktorëve më të rëndësishëm lehtësues e kontekstual (të cilët u paraqiten më lartë) dhe mund të ndikojnë në mënyrë efektive procesin e mësimdhënies në klasë.

Duke vëzhguar shkollën menjë sy kritike dot hasim shumë gjëra për tu përmirësuar por në fakt në teori është ndryshe, dhe në praktik është ende me ndryshe

KONKLZIONI

ANALIZAT PËRFUNDIMTARE PËR TË DY SHKOLLAT FILLORE

ANALIZA E TË DHËNAVE NGA INTERVISTA E DREJTORIT

Për analizën e pyetësorëve u përdor programi ëord, ndërsa në analizën e të dhënave cilësore, lexuesit për t'i ofruar rendin dhe kuptimin e të dhënave të mbledhura, u zbatuan dy faza:

- faza e klasifikimit e cila njëkohësisht ishte edhe faza finale, ku pas çdo interviste, u morën shënime dhe u theksuan temat kryesore dhe
- faza e përshkrimit.

PËRFUNDIMI

Drejtori ka njohuritë e mjaftueshme për të drejtuar e menaxhuar institucionin arsimor në përputhje me legjislacionin e dokumenteve themelore zyrtare dhe sipas teorive e praktikave bashkëkohore.

Reforma është e rëndësishme në sektorin e arsimit dhe përbën padyshim një hap cilësor drejt lehtësimit të komunikimit, duke e bërë punën komplekse të mësimdhënies e mësimnxënies sa më efikase dhe më profesionale.

Kjo Strategji duhet të jetë e rëndësishme në inaugurimin e reformimeve tona të përbashkëta për një sistem arsimor transparent dhe me cilësi, ku dotë jenë vetë qytetarët që me vullnetin e tyre të lirë të zgjedhin në një kohë të shpejtë dhe me një kosto efektive të ulët komunikimin ndërmjet tyre.

Përmirësimi i komunikimit dhe bashkëpunimi në procesin e reformimit e decentralizimit të sektorit të arsimit është sfidë e rëndësishme, sepse komunikimi gjithpërfshirës është rruga e vetme drejt përmirësimit të cilësisë në arsim.

Përfundimisht arrijmë në konkluzion se çdo institucion kërkon menaxhim profesional për të aritur te qëllimi i duhur.

Nevojitet paanshmëri në marrjen e vendimeve, duke ruajtur dinjitetin profesional dhe njerëzor të secilit punëtor për të patur suksese në arritjen dhe zbatimin e objektivave dhe detyrave që dalin nga Plani Zhvillimor i Shkollës.

Drejtori bën Planifikime strategjike:

- Përqendrohet mbi objektivat që duhet arritur-këtë e bën duke shkëmbyer idetë e tij me të tjerët në shkollë.
- Harmonizon interesat konfliktuoze vendore-këtë e bën duke përcaktuar detyrë për cdonjërin vecmas

Nga këto rezultate konkludojmë se H1 është aritur plotësisht.

Nga kjo pasqyrë e të dhënave mund të konstatojmë se H₂ është arritur plotësisht,

Nga kjo mund të konkludojmë se menaxhimi në këto shkolla është në nivel të duhur.

Tetova qyteti me 7 shkolla fillore,po mundohet ti përshtatet mësimi modern ku e kanë të patjëtësueshme mësimin sipas Sistemit të Cambridges.

Arsimtarët dhe udhëheqësit e shkollës nuk mendojnë se ky system është adekuat për në Maqedoni,Ky sistem mund të jetë shumë i mirë por jo të aplikohet në Tetovë ku kushtet e shkollave nuk janë në nivel të duhur,ka mungesa të llojllojshme.

Nga punimi që u krye u vu re se gjithashtu motivimi është një proces që shoqëron gjithë jetën e shkollës duke realizuar ndërthurjen e elementeve njëri me tjetrin që jeta e shkollës të funksionojë si një e tërë.

Drejtuesi është element shumë i rëndësishëm i organizimit dhe menaxhimit të jetës në shkollë dhe harmonisë që krijohet në të. Roli i tij është vendimtar në ecurinë e shkollës. Motivimi i duhur i drejtuesit dhe përcjellja e këtij motivimi në hallkat e tjera të jetës së shkollës sigurisht që e çon shkollën drejt suksesit.

Faktor tjetër shumë i rëndësishëm i jetës së shkollës është arsimtari. Arsimtari duhet të jetë plot motivim dhe energji që jo vetëm e zotëron por edhe e transmeton tek nxënësi. Ky motivim transmetohet tek nxënësi nëpërmjet formave të ndryshme: sjelljes, komunikimit, metodave, teknikave, mjeteve, shpërblimeve etj.

Kërkimet hulumtuese zbuluan se arsimtarët që ishin të motivuar dhe ndjeheshin mirë në vendin e punës ndikonin pozitivisht në motivimin e nxënësve duke rritur produktivitetin. Këta arsimtar i bënin nxënësit të ndjeheshin të rëndësishëm dhe të vlefshëm. Ka ardhur koha që mësimi interaktiv e bashkëpunues të jetë bazë e procesit të mësimdhënies në mënyrë që të mësuarit të jetë proces i thjeshtë, i kuptueshëm, i pëlqyeshëm.

Nga studimi dolëm në përfundimin se arsimtarët e motivuar kanë rezultate të larta në përdorimin e metodave të reja bashkohore dhe e frekuentojnë rregullisht shkollën ndërsa arsimtarët e pamotivuar kanë rezultate të ulëta dhe nuk e frekuentojnë rregullisht shkollën. Shkalla e motivimit në nxënës të ndryshëm është e ndryshme. Disa nxënës kanë motivim të brendshëm dhe performanca e tyre është e lartë në shumicën e lëndëve mësimore. Nxënës të tjerë kanë mëotivim të jashtëm nga mësuesi ose nga prindi dhe performanca e tyre është në nivel mesatar, parapëlqejnë lëndë të caktuara dhe kanë pak interes për lëndët e tjera.

Marrëdhënia që krijon mësuesi me nxënësin ndikon drejtpërdrejtë në performancën e nxënësit në lëndën e caktuar. Sa më komod të ndjehet nxënësi në shkollë në raport me mësuesit, nxënësit, mjedisin e jashtëm e të brendshëm të shkollës aq më i lartë është motivimi dhe për rrjedhojë edhe performanca e tij.

Prindërit përbëjnë një tjetër element të rëndësishëm pasi ata ndikojnë drejtpërdrejt në motivimin e fëmijëve dhe arsimtarëve të tyre. Pritshmëria që prindërit kanë prej fëmijëve të tyre reflektohet në motivimin e nxënësit dhe për pasojë edhe në performancën e tyre. Sa më e lartë të jetë pritshmëria e prindit dhe zgjedhja e mënyrave të duhura për motivimin e fëmijës aq më i motivuar do të jetë fëmija dhe më e lartë do të jetë performanca.

E gjithë kjo tregon që zinxhiri drejtor-arsimtar-prind-nxënës është shumë e rëndësishme dhe ka një lidhshmëri të ngusht mes veti.

“ARSIMI ËSHTE SHTYLLA E POPULLIT”

Përpjekjet për të ndryshuar nuk janë gjithmonë të suksesshme menjëherë. Bëhen gabime. Megjithatë, në qoftë se mësojmë nga ato gabime, ka shumë të ngjarë ta arrijmë nivelin e suksesit që jemi duke kërkuar.

Ndryshimi kërkon kurajë për të fi lluar dhe durim për ta çuar atë deri në fund.

Më në fund, ekziston një besim i përgjithshëm midis autorëve se të gjithë mësuesit mund të bëjnë një punë më të mirë nga ajo që janë duke bërë.

Rekomandimet e ofruara nga autorët e kapitujve të ndryshëm janë ndryshimet që ata besojnë të jenë më të rëndësishmet, ndërsa ju përpiqeni të jeni më i mirë sot se sa ishit dje.

Është shpresa jonë e singertë që çdo mësues që e lexon këtë libër do të marrë me vete diçka nga ai, një ide, një taktikë, një strategji, diçka që do t'i ndihmojë ata të bëhen mësues më të mirë.

KAPITULLI 5

Rishikimi I literaturës

LITERATURA E PËRDORUR:

1. Mësimdhënia dhe të nxënësit e gjuhëve të huaja në epokën e internetit.(www.netenglisholsa.org)-Tiranë,2014
2. Strategji dhe Teknika të të mësuarit (materiale për mësimin në gjuhën e prejardhjes)-Nxitje Didaktike
3. Integrimi I Teknologjisë informative të komunikimit në mësimdhënie dhe nxënie.(Arbnesha Mexhuni,Prishtinë 2014)
4. Strategji të Mësimdhënies dhe të të nxënës për klasat mendimtare. (charles Temple,Alan CraëFord,ëendy Saul,Samuel R.Matheës,James makinster)
5. Revista Shqiptare e Studimeve Arsimore (volumi2,nr1,2014)
6. Hasan Jashari “Sociologjia e arsimit’
7. Majkell Fullan “Kuptimi i ri i ndryshimit ne arsim”
8. Majkell Fullan ‘Forcat e ndryshimit “
9. prof Besim Dyla “Didaktika”-botimi i dytë i përpunuar Gjakovë 1995
10. “KOMUNIKIMI ORGANIZATIV QASJET DHE PRIRJET”-MICHAEL J.PAPA,TOM.D.DANIELS,BARRY K.SPIKER
11. “NORMALNOST I PATOLOGJIA VO DETSTVOTO”-ANA FROJD
12. SFIDAT E ARSIMIT SIPËROR NË GJUHËN SHQIPE NË RM-Dr.Dashmir Idrizi

Videot:

- https://www.youtube.com/ëatch?v=7Rts70S_X3A
- <https://www.youtube.com/ëatch?v=8lKBA8XZj8>
- <https://www.youtube.com/ëatch?v=jemmuKxGKL8>

LINKE TË SUGJËRUARA

Për një shkollë me një plan program të mirë dhe me një udhërfyës të mirë sugjeroj këto linke;

- <http://www.vet.al/files/ligje%20etj/Inspektimi%20dhe%20vleresimi%20i%20brendshem%20i%20shkolles%20Udhezuesi%20i%20shkolles.pdf>

Për një shkollë me planifike të ndryshme dhe modeste;

- <http://ipkmasht.rks-gov.net/ëp-content/uploads/2015/11/Zhvillimi-i-udh%C3%ABheqjes-arsimore-NSO.pdf>

Mund të referohet te libri “Komunikimi Organizativ qasjet dhe prirjet” nga Michael J.Papa, Tom D.Daniels, Barry K.Spiker

-Në këtë libër mund të gjejmë 14 parimet e Fajollit të cilët na udhëzojnë për një udhëheqje sa më të suksesshme

- http://www.zgefdergi.com/Makaleler/1120813851_20_12_ID_306.pdf

-Në këtë link-punim mund të lexohet për karakteristikat e drejtorëve të suksesshëm

SHTOJCA:

PYETSORI PËR ARSIMTARËT

1. Me ndryshimin e drejtorit sa ndryshuan gjërat në shkollën tuaj ?
 - a) Nuk ndryshuan aspak
 - b) Ndryshuan
 - c) Ndryshuan shumë
2. Si e vlersoni punën e drejtorit në shkollë ? (Prej 1 deri në 5).
 - a) 1
 - b) 2
 - c) 3
 - d) 4
 - e) 5
3. A ka kushte shkolla për ta treguar punën tuaj të suksesshme ?
 - a) Po, ka ?
 - b) Jo, ska ?
4. Cili është problem kryesor I shkollës tuaj ?
 - a) Menaxhimi I drejtorit
 - b) Kushtet e punës
 - c) Mos interesimi I prindërve
 - d) Sistemi Cambridge
5. Si I menaxhoni problemet që munde të dalin gjatë punës ? I zgjidhni vet apo kërkonte ndihmë nga drejtori, pedagogu apo psikologu?
 - a) Drejtori
 - b) Pedagogu
 - c) Psikologu
 - d) Nga të gjithë

6. A e raportoni cdo punë tuajën te drejtori ?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Mvaret
7. Si e vlereson punën tuaj, drejtori ?
- a) Në aspektin metodologjik
 - b) Nga këdvështrimi i komuniikimit me nxënësit
 - c) Në aspektin e dijenisë
8. Si meren vendimet ne shkollen tuaj ?
- a) Vendimet i merr vet drejtori
 - b) SEDqDXSVendimet merren bashke në kolektivë
9. Sa është i pajisur shkolla juaj për ti plotsuar nevojat e të gjithë nxenësve gjatë orëve të mësimi? (ëvlersoni në baze komunale)
- a) Shkëlqyer
 - b) Shumë mirë
 - c) Mirë
 - d) Mjaftueshëm
 - e) Jo mjaftueshëm
10. Sistemi apo formati i menaxhimit tëshkollës a është shtytës për sukses tuaj ?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Mvaret
- 11.A I zbatoni Metodat e reja bashkohore?
-

12.A keni mjete të duhura për ti zbatuar metodat e reja bashkohore?

PYETSORI PËR NXËNËSIT

1. A e njihni drejtorin ?

a) Po

b)

c) Jo

2. Vizato drejtorin!



3. Me ndryshimin e drejtorit sa ndryshuan gjërat në shkollë?

a) Nuk ndryshuan aspak

b) Ndryshuan

c) Ndryshuan shumë

4. Si evlersoni punën e drejtorit në shkollë ?

a) 1

b) 2

c) 3

d) 4

e) 5

5. Cka kishit dashur të ketë shkolla juaj ?

6. A mendoni se drejtori kujdeset për ju ?

a) Po

b) Jo

7. A mendoni se shkolla ofron të gjitha mundësit apo kushtet që ju të keni sa me lehtë?

a) Po

- b) Jo
 - c) Jo edhe aq shumë
8. Gjatë orëve që qëndroni në hapsirën e shkollës a e ndjeni veten të lirë dhe a kënaqeni?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Në disa raste
9. Kur të rriteni a keni pretendime që të bëheni drejtor, si drejtori juaj?
- a) Po
 - b) Jo

PYETSORI PËR PRINDËRIT

1. A jeni të kënaqur nga shkolla ku mëson fëmija juaj ?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Në disa raste

2. Si e shihni drejtorin e shkollës?
 - a) Drjetor me ambicie të larta
 - b) Drejtor I suksesshëm

3. A mendoni se respektohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijës tuaj nga shkolla dhe mësimdhënësit?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Jo, cdo herë


4. Si e vlersoni punën e drejtorit në shkollë?
 - a) 1
 - b) 2
 - c) 3
 - d) 4
 - e) 5

5. Cili është problem kryesor i shkollës që duhet të zgjidhet ?
 - a) Menaxhimi i punës
 - b) Kushtet e punës për arsimtarët
 - c) Mos interesimi i prindërve
 - d) Sistemi Cambridge

6. A mendoni se mësimdhënësit kanë standartë cifte (diskriminim) drejt nxënësve në baza nacionale, fetare dhe ekonomike ?
- a) Po
 - b) Jo
7. A mendoni se mësimdhënësit i vlersojnë nxënësit në nivel të duhur dhe në mënyrë të drejtë?
- a) Po
 - b) Jo
8. Në sa raste keni biseduar me drejtorin ?
- a) Në shumë raste
 - b) Në disa raste
 - c) Aspak
 - d) Nuk e njoh drejtorin

INTERVISTA ME DREJTORIN

1. Ju lutemi përshkruani auto-biografinë tuaj ne pika të shkurta?
2. Sa kohë keni punuar si profesoreshë?
3. Tash më sa kohë kanë kaluar që jeni drejtoreshë e kësaj shkolle?
4. Sa paralele gjegjësisht sa klasa dhe nxënës udhëhiqni ju si drejtorë shkolle?
5. Cka ndryshoi më shumë me kalimin nga profesore në drejtorë shkolle?
6. Cila ishte puna e parë që realizuat për shkollën ?
7. Si e vlerësonin suksesin gjegjësisht mësimdhënjen e arsimtarëve/mësuesve në shkollën tuaj ?
8. Si qëndron bashkëpunimi juaj mes kolegëve ?
9. Cfar kushte ofron shkolla për të patur sukses arsimtarët/mësuesit
10. A keni laborator dhe të njetat a janë në funksion ?
11. Cili është problem kryesor i shkollës ?
12. Si I menaxhoni problemet që mund të dalin gjatë punës ? I zgjidhni vet apo kërkonin ndihmë nga pedagogu dhe psikologu?
13. A e raportoni punën tuaj te kolegët ? cfar drejtori jeni autocrat apo demokrat?
14. Cfar bëni për ti motivuar mësimdhënësit ?
15. A i zbatoni metodat e reja bashkohore?Sa keni mundësi për ti zbatuar?
16. Po bashkëpunimi me prindërit. A keni këshillin e prindërve ?
17. Sa degjohen dhe sa plotësohen kërkesat dhe sugjerimet e prindërve?
18. Sa respektohen dhe mbrohen të drejtat e fëmijëve nga shkolla dhe mësimdhënësit? Sigura?
19. Dukë marrë parasysh se edhe ju keni qenë arsimtarë a mendoni se sistemi aktual I Cambridge është më I mirë dhe I dobishëm se ai më parë?
20. A mendoni se arsimi në maqedoni është duke shkuar rrugës së duhur apo duhet ndryshme rrënjësore?
21. Cka do të kishit ndryshuar në shkollën tuaj për të pasur më shumë sukses?
22. Cka është misioni I shkollës tuaj ?
23. A funksionon sistemi drejtues i shkollës?
24. Kur pranuat postin drejtor, ku ishte shkolla? Ku është dhe ku nga po shkoni ?
25. Ju si drejtor I suksesshëm dhe me plot përvoj cka do të kishit sugjeruar për ata që kanë synime të bëhen drejtorë?



"Suksesi nuk është çelësi i lumturisë. Lumturia është çelësi i suksesit. Nëse e doni atë që e bëni, ju do të jeni të suksesshëm."

- Albert Schweitzer